



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 258

**PËR PROMOVIMIN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE TË
RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PROMOVIMIN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE TË
RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË**

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj përcakton kornizën e përgjithshme për promovimin e përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Republikën e Kosovës, me qëllim të rritjes së përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme dhe Bashkëprodhimit në sektorin e energjisë elektrike, në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes dhe sektorin e transportit, me qëllim të përmbushjes së nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit, përmirësimit dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe ofrimit të përfitimeve sociale dhe shëndetësore dhe promovimit të mundësive të barabarta të punësimit në sektorin e energjisë.

2. Ky ligj pjesërisht transponon Direktivën (BE) 2018/2001 për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, miratuar me Vendimin (2021/14/MC-EnC) të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin hartimin e politikave energjetike dhe zhvillimin e kornizës rregullative për promovimin e përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë promovimin e Skemave Mbështetëse konkurruese, efiçiente dhe transparente.

2. Ligji përcakton parimet dhe objektivat e politikave për Energjinë e Ripërtërishme duke definuar detyrat dhe funksionet e palëve të interesit në lidhje me mbështetjen e Energjisë së Ripërtërishme, si dhe:

2.1. Vendos një cak të detyrueshëm për përqindjen e përgjithshme të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë për Republikën e Kosovës deri në vitin 2030;

2.2. Përcakton përgjegjësitë dhe procedurat administrative të subjekteve lidhur me Energjinë e Ripërtërishme;

2.3. Përcakton të drejtat dhe obligimet për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të bazuara në Burime të Ripërtërishme të Energjisë dhe themelon mekanizmat konkurrues për mbështetjen e kapaciteteve të reja prodhuese me bazë në Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.

2.4. Përcakton parimet e Skemës Mbështetëse për Prodhimin e energjisë elektrike, si dhe energjisë për ngrohje dhe ftohje nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;

2.5. Përcakton parimet bazë për qasjen në rrjet për Energjinë e Ripërtërishme;

2.6. Nxitë konsumatorët që të prodhojnë, ruajnë e shesin tepicën e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;

2.7. Përcakton parimet e zbatueshme për Fondin Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme;

2.8. Përcakton kriteret e qëndrueshmërisë dhe kursimit të emetimeve nga gazrat me efekt serrë për prodhimin dhe përdorimin e Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe Biomassës;

2.9. Rregullon lëshimin e Garancive të Prejardhjes për energjinë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Biomasa Bujqësore** - Biomasa e prodhuar nga bujqësia, në përputhje me dispozitat e ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural;

1.2. **Energjia Ambientale** - energjia termike e krijuar në natyrë dhe energjia e akumuluar në mjedis me kufij të ngushtë, që mund të ruhet në ajrin e ambientit, me përfshirje të ajrit të shkarkimit, ose në ujërat sipërfaqësore ose të zeza;

1.3. **Instalimet e vet-prodhimit pas njehsorit** – instalimet e prodhimit të cilat përdoren nga Vetë-Konsumatorët për të prodhuar energji elektrike për nevojat vetanake pa injektuar atë në rrjet;

1.4. **Biokarburantet** - lëndë djegëse të lëngshme për transport të prodhuar nga Biomasa;

1.5. **Biogaz** - lëndë djegëse e gaztë të prodhuara nga Biomasa;

1.6. **Biolëngje** - lëndë djegëse të lëngshme si burim energjie të ndryshme nga ato për transport, duke përfshirë energjinë elektrike dhe termike, të prodhuar nga Biomasa;

1.7. **Biomasa** - pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga bujqësia, duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore, nga pylltaria dhe industritë përkatëse, duke përfshirë peshkatarinë dhe akuakulturën, si dhe pjesën e biodegradueshme të Mbeturinave, duke përfshirë Mbeturinat industriale dhe komunale me prejardhje biologjike;

1.8. **Derivatet e biomasës** - lëndë djegëse e gaztë dhe e ngurtë të prodhuara nga Biomasa;

1.9. **Bashkëprodhimi** - Prodhimi i njëkohshëm në një proces të energjisë termike dhe të energjisë elektrike dhe/ose të energjisë mekanike;

1.10. **Procesi i Ofertimit Konkurrues** - procedura transparente, jodiskriminuese dhe konkurruese, që mundëson pjesëmarrjen e një numri të mjaftueshëm të kompanive në të cilën mbështetja financiare jepet në bazë të ofertës të dorëzuar nga ofertuesit në një proces konkurrues;

1.11. **Kontrata për Diferencë** - lloji i mbështetjes përmes barazimit financiar ku një premium rrëshqitës, i përbërë nga ndryshimi midis Çmimit Referent dhe Çmimit të Fiksuar, barazohet ndërmjet Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Prodhuesit të Privilegjuar. Nëse Çmimi Referent është më i ulët se Çmimi Fiksuar, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme i paguan ndryshimin Prodhuesit të Privilegjuar. Nëse Çmimi Referent është më i lartë se Çmimi Fiksuar, Prodhuesi i Privilegjuar i paguan ndryshimin Operatorit për Energjinë e Ripërtërishme;

1.12. **Kontrata për Premium** - lloji i mbështetjes përmes barazimit financiar ku një premium fiks mbi çmimin e tregut paguhet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme për Prodhuesin e Privilegjuar për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar;

1.13. **Kontrata për Mbështetje** – kontratë në bazë të së cilës Prodhuesit të Privilegjuar i jepet mbështetje sipas një Skeme Mbështetëse në formën e një

Marrëveshje të Blerjes së Energjisë /MBE, një Kontrate për Premium ose një Kontratë për Diferencë;

1.14. **Palë Kontraktuese** – një palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

1.15. **Ngrohja Qendrore ose Ftohja qendrore** - shpërndarja e energjisë termike në formën e avullit, ujit të nxehtë ose lëngjeve të ftohura, nga burimet qendrore ose të decentralizuara të prodhimit përmes një rrjeti në ndërtesa ose lokacione, për përdorimin e hapësirës ose procesit të ngrohjes ose ftohjes;

1.16. **Ngrohje dhe Ftohje Qendrore Efiçiente** - një sistem Ngrohjeje ose Ftohjeje Qendrore që përdor të paktën pesëdhjetë përqind (50%) Energji të Ripërtërishme, pesëdhjetë përqind (50%) ngrohje nga mbeturinat, shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) nxehtësi të bashkëprodhuar ose pesëdhjetë përqind (50%) të një kombinimi të kësaj energjie dhe ngrohjeje;

1.17. **Energjia nga Burimet e Ripërtërishme ose Energjia e Ripërtërishme** - energjia prej burimeve jo-fosile, përkatësisht energjinë të prodhuar nga era, solare (termale apo fotovoltaike) dhe gjeo-termale, energji të ambientit, nga deti, hidro-energji, biomasë, energji nga gazrat e deponive, gazi nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi;

1.18. **Traktati i Komunitetit të Energjisë** –akti i themelimit të Komunitetit të Energjisë në mes të Bashkimit Evropian (BE) dhe një numri të shteteve të treta për të zgjeruar tregun e brendshëm të energjisë të BE-së në Evropën Juglindore dhe më gjerë;

1.19. **Çertifikata e Performancës Energjetike** - çertifikatë e njohur nga autoritetet kompetente shtetërore apo personi juridik i caktuar prej tyre, e cila paraqet performancën energjetike të ndërtesës apo njësisë së ndërtimit, siç përcaktohet me Ligjin për Performancën Energjetike të Ndërtesave;

1.20. **Rregullatori** – Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Republikës së Kosovës e themeluar sipas ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

1.21. **Kulturat Ushqimore dhe Ushqimi** - kulturat e pasura me niseshte, kulturat e sheqerit ose kulturat vajore të prodhuara në tokë bujqësore si kulturë kryesore, duke përfshirë Mbetjet, mbeturinat ose materialet ligno-celulozë dhe kulturat e ndërmjetme, siç janë kulturat kapluese dhe mbuluese, me kusht që përdorimi i kulturave të tilla të mos shkaktojë kërkesë për tokë shtesë;

1.22. **Biomasa Pyjore** - biomasa e prodhuar nga pylltaria në përputhje me dispozitat e ligjit për Pyjet;

1.23. **Furnizuesi i Derivateve** - subjekti që operon si një importues apo shitës me shumicë dhe furnizon lëndë djegëse te konsumatorët;

1.24. **Prodhimi** - procesi fizik ose kimik të shndërrimit të lëndëve djegëse ose Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në energji elektrike, ngrohje ose forma të tjera të energjisë;

1.25. **Gjeotermike** - energjia e ruajtur në formë të nxehtësisë nën sipërfaqen e ngurtë të tokës;

1.26. **Bruto Konsumi Përfundimtar i Energjisë** - produktet e energjisë të liferuara për qëllime energjetike për industrinë, transportin, ekonomitë familjare, shërbimet duke përfshirë shërbimet publike, bujqësinë, pylltarinë dhe peshkatarinë, konsumin e energjisë elektrike dhe ngrohjes nga sektori i energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe lëndëve djegëse për transport, si dhe humbjet e energjisë elektrike dhe ngrohjes në shpërndarje dhe transmetim;

1.27. **Garancia e Origjinës** - dokumenti elektronik që ka funksion të vetëm të paraqesë dëshmi para një konsumatori fundor se një pjesë apo sasi e caktuar e energjisë është prodhuar nga Burime të Ripërtërishme të Energjisë dhe e cila mund të shfrytëzohet për shitje;

1.28. **Teknologjitë Inovative të Ripërtërishme** – forma e zgjidhjeve ose teknologjitë e reja që përdorin burimet e ripërtërishme të energjisë, të tilla si, por pa u kufizuar në teknologjitë e ruajtjes së energjisë, duke përfshirë bateritë, deponimin termik, teknologjitë për prodhimin e hidrogjenit të ripërtërishëm, pompat e nxehtësisë, teknologjitë gjeotermike dhe termike diellore, si dhe humbjet nga ngrohja dhe ftohja;

1.29. **Vetë-Konsumatorët e Burimeve të Ripërtërishme në veprimtari të përbashkët** - një grup prej së paku dy (2) Vet-Konsumatorëve të Burimeve të Ripërtërishme që janë të vendosur në të njëjtin objekt apo ndërtesë shumëbanesore;

1.30. **Ministria** - Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë;

1.31. **Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK)** – akti i planifikimit strategjik dhe dokumenti bazë për planifikimin e politikave energjetike dhe klimatike për Republikën e Kosovës, i cili në mes tjerash përmban caqet dhe politikat për zhvillimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë të ndërlidhura me objektivat kombëtare të dekarbonizimit;

1.32. **Operatorët e Rrjetit** - operatori i sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike.

1.33. **Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike** - veprimet të cilat sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës përkufizohen si vepër penale në veçanti lidhur me vjedhjen e energjisë elektrike, manipulimin e njehsorit të energjisë elektrike dhe shmangien e njehsorit të energjisë elektrike dhe kyçjen ose rikyçjen e paautorizuar në furnizim të energjisë elektrike të transmetuar nga ose nëpërmjet një rrjeti të transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike;

1.34. **Palët e Komunitetit të Energjisë** –Palët Kontraktuese, si dhe Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

1.35. **Marrëveshja e Blerjes së Energjisë (MBE)** –lloji i mbështetjes të barazuar fizikisht, ku Operatori i Energjisë së Ripërtërishme si marrës i caktuar garanton blerjen e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar me një çmim të paracaktuar;

1.36. **Prodhues i Privilegjuar** - çdo Prodhues të Energjisë së Ripërtërishme i cili përfiton nga Skema Mbështetëse sipas dispozitave të këtij ligji;

1.37. **Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit** –një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Ministrisë dhe Prodhuesit të Privilegjuar që përcakton termat dhe kushtet duke përfshirë afatet për ndërtimin e një objekti për prodhimin e energjisë elektrike nga një Prodhues i Privilegjuar;

1.38. **Çmimi Referent** –çmimi për orë i vendosur në tregun e Kosovës një ditë përpara me të cilin operon Bursa Shqiptare e Energjisë. Nëse çmimi i tregut në Kosovë një ditë përpara nuk mund të përcaktohet, Çmimi Referent përcaktohet nga Rregullatori, përmes akteve nënligjore bazuar në metodologjinë për caktimin e Çmimit Referent. Në rast se Çmimi Referent është negativ, ai konsiderohet zero për qëllime të barazimit financiar sipas një Kontrate për Diferencë;

1.39. **Fondi Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë** – tërësia e fondeve në kuadër të obligimeve të energjisë nga burimet e ripërtërishme të inkasuara nga konsumatorët fundorë, nga buxheti qendror, taksa e aplikueshme mjedisore, donacionet, në dispozicion tek operatori i energjisë së ripërtërishme për të mbuluar kostot e skemës mbështetëse, jobalancet sipas rastit të prodhuesve të energjisë së ripërtërishme dhe operatorit të energjisë së ripërtërishme;

1.40. **Burimet e Ripërtërishme të Energjisë** - burimet jo-fosile, përkatësisht era, dielli (solare termike dhe solare fotovoltaike) dhe Energjia Gjeotermike, Energjia Ambientale, baticat, valët dhe energji tjetër nga oqeani, hidroenergji, Biomasa, gazi nga deponitë, gazi nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe Biogazi;

1.41. **Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme** - personi juridik:

1.41.1. i cili, në pajtim me ligjin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe/apo me ligjin për lirinë e asocimit për organizatat jo-qeveritare, bazohet në pjesëmarrjen e hapur dhe vullnetare, është autonom dhe kontrollohet nga aksionarët ose anëtarët që ndodhen në afërsi të projekteve të Energjisë së Ripërtërishme që janë në pronësi dhe zhvillohen nga ai person juridik;

1.41.2. aksionarët ose anëtarët e të cilit janë persona fizik, Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) apo komunat dhe konsumatorët, duke përfshirë familjet me të hyra të ulëta ose të cenueshme;

1.41.3. qëllimi kryesor i të cilit është të sigurojë dobi mjedisore, ekonomike ose sociale për aksionarët apo anëtarët e tij, apo për zonat lokale ku vepron, në vend të fitimeve financiare;

1.42. **Obligimi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme** – skemë që kërkon nga prodhuesit dhe furnizuesit që në prodhimin përkatësisht furnizimin e energjisë të

përfshijnë një pjesë të caktuar të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, si dhe që kërkon nga konsumatorët e energjisë të përfshijnë një pjesë të caktuar të energjisë nga Burimet e ripërtërishme në konsumin e tyre dhe t'i paguajnë për një sasi të kWh në Fondin Mbështetës për Energji të Ripërtërishme, duke përfshirë skemat sipas të cilave këto kërkesa mund të përmbushen duke përdorur çertifikatat e gjelbra;

1.43. Operator i Energjisë së Ripërtërishme – subjekti i caktuar për të qenë palë homologe e Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme që përfitojnë nga Skema Mbështetëse dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme;

1.44. Prodhues i Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme – personi fizik ose juridik që prodhon energji nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;

1.45. Lëndë djegëse nga Burimet e Ripërtërishme në transport, të lëngëta dhe të gazta, me origjinë jobiologjike – lëndët djegëse të lëngëta ose të gazta që përdoren në sektorin e transportit përveç biokarburanteve ose biogazit;

1.46. Marrëveshja për Blerjen e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme – kontratë sipas së cilës një person fizik ose juridik pajtohet të blejë energji elektrike të Ripërtërishme drejtpërdrejt nga prodhuesi i energjisë elektrike;

1.47. Vetë-konsumator nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë – konsumatori fundor që operon brenda hapësirave të tij, që prodhon energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak, i cili mund të ruajë ose shesë energji elektrike të Ripërtërishme të prodhuar nga vetë ai, me kusht që, për një Vetë-konsumator të Burimeve të Ripërtërishme jo-familjar, këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale;

1.48. Objekti i Vet-konsumatorëve nga Burime të Ripërtërishme – objekti i gjenerimit të instaluar në një ambient të konsumatorit fundor të lidhur me instalimet e brendshme të konsumatorit, të cilët gjenerojnë energji elektrike të ripërtërishme për konsum vetanak, dhe të cilët mund ta ruajnë atë energji në objektin e vet për ruajtje ose ta shesin energjinë elektrike të vet-prodhuar nga burimet e ripërtërishme;

1.49. Mbetje – substancë që nuk është produkt përfundimtar, nuk është qëllimi kryesor i procesit të prodhimit dhe procesi nuk është modifikuar qëllimisht për ta prodhuar atë;

1.50. NMVM - ndërmarrje Mikro, të Vogël ose të Mesme, siç përcaktohet në ligjin përkatës për investime;

1.51. Çmimi i Fiksuar – çmimi përfundimtar që përfiton Prodhuesi i Privileguar i energjisë elektrike, si rezultat i dhënies nga një Proces i Ofertimit Konkurrues;

1.52 Skema Mbështetëse – secili instrument apo mekanizëm i aplikuar nga Republika e Kosovës, që promovon përdorimin e energjisë së ripërtërishme për:

1.52.1. uljen e kostos së prodhimit të kësaj energjie;

1.52.2. rritjen e çmimit me të cilin mund të shitet kjo energji;

1.52.3. rritjen e vëllimit të energjise së blerë;

1.52.4. përfshirë, por pa u kufizuar në to, ndihmën në investime, lirimet apo zbritjet tatimore, rimbursimet tatimore, skemat e mbështetjes direkte të çmimeve, tarifatat nxitëse dhe pagesat rrëshqitëse ose fikse të premiumeve;

1.53. **Operatori i Sistemit Termik** – person fizik ose juridik, përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e një sistemi të ngrohjes ose ftohjes;

1.54. **Pragu** – kapaciteti maksimal i lejueshëm i instaluar të objektit të Vetëkonsumatorit nga Burimet e Ripërtërishme i lidhur me instalimet e brendshme të Vetëkonsumatorit të Ripërtërishëm, me të cilin Vetëkonsumatori i Ripërtërishëm mund të marrë pjesë në Skemën Mbështetëse;

1.55. **Mbeturina** – çdo substancë ose objekt që mbajtësi i hedh ose synon ose kërkohet të hedhë, duke përjashtuar substanca që janë modifikuar ose kontaminuar qëllimisht për të përmbushur këtë përkufizim;

1.56. **Humbjet e Ngrohjes dhe Ftohjes** –ngrohja apo ftohja e pashmangshme në aspektin termodinamik të prodhuar si nënprodukt në stabilimentet industriale ose të prodhimit të energjisë, në sektorin terciar, që avullohet si i pashfrytëzuar në ajër apo ujë pa qasje në sistem të ngrohjes apo ftohjes qendrore, ku është përdorur apo përdoret procesi i bashkëprodhimit, apo ku bashkëprodhimi nuk është i arritshëm.

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj dhe që nuk janë përkufizuar këtu kanë kuptimin e dhënë në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë Termike.

KAPITULLI II

POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT E BURIMEVE TË RIPËRTËRISHME TË ENERGISË

Neni 4

Politikat për Burimet e Ripërtërishme të energjisë

1. Politikat në fushën e Burimeve të Ripërtërishme synojnë këto objektiva:

1.1. Promovimin e rritjes së përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës me kosto sa më efektive;

1.2. Reduktimin e përdorimit të lëndëve me djegie fosile dhe zvogëlimin e varësisë nga importet e energjisë elektrike;

1.3. Reduktimin e emetimit të gazrave serrë, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;

1.4. Rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe sigurisë së furnizimit me energji në Republikën e Kosovës;

1.5. Arritjen e caqeve të përcaktuara për pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë dhe në sektorin e transportit;

1.6. Publikimin e informatave në lidhje me përparësitë dhe përfitimet nga përdorimi i Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;

1.7. Sigurimin gjithëpërfshirës të fuqisë punëtore, përfshirjen gjinore si dhe anëtarët e komuniteteve të marginalizuara, në sektorin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;

1.8. Promovimin e zhvillimit të një tregu të integruar konkurrues rajonal të energjisë dhe integrimin në këtë treg të energjisë nga burimet e ripërtërishme, në bashkëpunim me Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

1.9. Pajtueshmërinë me detyrimet e përcaktuara në traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

1.10. Rritjen e efikasitetit të energjisë së bashku me përdorimin e energjisë së ripërtërishme.

Neni 5

Zbatimi i Politikave të Burimeve të Ripërtërishme

1. Politikat në fushën e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme zbatohen përmes:

1.1. Një kornizë ligjore, të plotësuar me akte nënligjore, për nxitjen e përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, duke përfshirë Skemat Mbështetëse dhe financimin e tyre;

1.2. Vendosjes së caqeve kombëtare për pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë dhe në sektorin e transportit, si edhe obligimeve përkatëse të raportimit;

1.3. Publikimit të informacionit përkatës në lidhje me përfitimet, kostot dhe Skemat Mbështetëse;

1.4. Vendosjes së rregullave për qasjen dhe funksionimin e rrjeteve për Energji të Ripërtërishme;

1.5. Rregullave për treg dhe balancim të Energjisë së Ripërtërishme;

1.6. Rregullave për integrimin e Vet-Konsumatorëve të Energjisë nga burimet e Ripërtërishme dhe Bashkësive të Energjisë së Ripërtërishme në sektorin e energjisë elektrike;

1.7. Sistemit elektronik për lëshimin, bartjen dhe anulimin e Garancive të Origjinës;

1.8. Kornizës ligjore për përdorimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes, si dhe në sektorin e transportit;

1.9. Strukturës institucionale që mundëson zbatimin efikas të politikave të Energjisë së Ripërtërishme.

2. Politikat në fushën e Energjisë së Ripërtërishme zbatohen nga Qeveria, Ministria, Rregullatori dhe subjektet e tjera siç parashihet me dispozitat përkatëse të këtij ligji, ligjeve të tjera që e rregullojnë sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës dhe akteve nënligjore të nxjerra sipas këtyre ligjeve.

3. Subjekti që vepron si Operator i Energjisë së Ripërtërishme është pala homologe e çdo Prodhuesi të Privilegjuar për barazimin fizik dhe/ose financiar në Skemën Mbështetëse.

4. Politikat për Energjinë nga Burimet Ripërtërishme zbatohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

Neni 6

Caqet dhe trajektorja kombëtare

1. Caku kombëtar për pjesëmarrjen e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë për vitin 2030 është tridhjetë e dy përqind (32%).

2. Caqet dhe trajektorja indikative elaborohet në planifikimin vjetor dhe afatgjatë, siç përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministria, dy (2) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Trajektorja indikative zhvillohet për periudhën deri në vitin 2030 për të arritur caqet nacionale për pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, dhe merr parasysh:

3.1. Zhvillimin e Procesit Konkurrues të Ofertimit, dhe

3.2. Karakteristikat e llojeve të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.

4. Për të vlerësuar pajtueshmërinë me cakun e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pjesëmarrja e energjisë nga burimet e Ripërtërishme llogaritet nga Ministria si Bruto Konsum Përfundimtar i energjisë nga burimet e Ripërtërishme pjesëtuar me Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë nga të gjitha burimet e energjisë.

Neni 7

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë

1. Ministria përgjegjëse për mjedis dhe Ministria përgjegjëse për energji hartojnë Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, i cili plan miratohet nga Qeveria.
2. Plani i veprimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë është pjesë integrale e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë i cili hartohet në përputhje me legjislacionin dhe obligimet ndaj Komunitetit të Energjisë.

Neni 8

Informimi

1. Ministria dhe Rregullatori, vënë në dispozicion informatat mbi rregullat, procedurat dhe masat mbështetëse për të gjitha palët përkatëse, siç janë konsumatorët, duke përfshirë konsumatorët me të ardhura të ulëta, konsumatorët e cenueshëm, Vetë-Konsumatorët e Burimeve të Ripërtërishme, pronarët dhe qiramarrësit e ndërtesave dhe banesave, Komunitetet e Energjisë së Ripërtërishme, ndërtuesit, instaluesit, arkitektët, furnizuesit e pajisjeve dhe sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike, si dhe furnizuesit e automjeteve që janë kompatibil me përdorimin e Energjisë së Ripërtërishme dhe të sistemeve inteligjente të transportit, si dhe publikun e gjerë.
2. Informatat mbi përfitimet neto, koston dhe efikasitetin energjetik të pajisjeve dhe sistemeve për përdorimin e ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë vihen në dispozicion nga furnizuesit e pajisjeve apo sistemeve, në pajtim me ligjin për efikasitetin e energjisë.
3. Ministria i përcakton skemat e çertifikimit ose skemat ekuivalente të kualifikimit për instaluesit e pajisjeve me Biomassë, sistemeve solare fotovoltaike dhe solare termike, sistemeve të cekëta Gjeotermike dhe pompave termike, të cilat përgatiten në bazë të programit të akredituar nga autoriteti përkatës, sipas kritereve të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Ministria.
4. Çertifikatat e lëshuara nga Palët e tjera të Komunitetit të Energjisë në pajtim me ato kritere njihen si ekuivalente me çertifikatat e lëshuara nga Ministria. Informatat për skemat e tilla vihen në dispozicion të publikut.
5. Ministria, Rregullatori dhe komunat përgatisin informatat e duhura, programe mbi aspektin e integritimit gjinor, si dhe udhëzime apo programe tjera trajnuese me qëllim të informimit të qytetarëve mbi ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë aktiv, si dhe për dobitë dhe çështjet tjera praktike, përfshirë aspektet teknike dhe financiare, për zhvillimin dhe përdorimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, përfshirë konsumin Vetanak nga Burimet e Ripërtërishme ose në kuadër të Komuniteteve të Energjisë së Ripërtërishme.

Neni 9
Regjistri publik i prodhuesve nga energjia e Ripërtërishme

1. Rregullatori mban regjistër elektronik të të gjithë Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme. Regjistri i tillë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Regjistri përfshin së paku informacionin vijues:
 - 2.1. Vendndodhja, kapaciteti, teknologjia e impiantit;
 - 2.2. Data e komisionimit;
 - 2.3. Nëse aplikohet forma, niveli dhe kohëzgjatja e mbështetjes.
3. Regjistri është i qasshëm për publikun dhe përditësohet në kohë reale.

KAPITULLI III
SKEMA MBËSHTETËSE

Neni 10
Skema Mbështetëse për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

1. Teknologjitë e mëposhtme të Energjisë së Ripërtërishme janë të pranueshme të përfitojnë nga Skema Mbështetëse e krijuar me këtë ligj:
 - 1.1. Teknologjitë e energjisë nga era;
 - 1.2. Teknologjitë e energjisë nga panelet fotovoltaike solare;
 - 1.3. Teknologjitë e energjisë nga Biomasa;
 - 1.4. Teknologjitë e energjisë nga Biogazi;
 - 1.5. Teknologjitë Gjeotermale të energjisë;
 - 1.6. Impiantet që shfrytëzojnë gazin nga deponitë urbane, ose nga trajtimi i ujërave të zeza/kanalizimit, me kusht që kjo teknologji është përkufizuar si teknologji e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë sipas standardit evropian;
 - 1.7. Impiantet e bashkëprodhimit që shfrytëzojnë Burimet e Ripërtërishme të Energjisë me efikasitet të lartë dhe impiantet termike të bazuara në Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
2. Teknologjitë Inovative që përdorin Burime të Ripërtërishme të Energjisë, dhe janë në zhvillim të hershëm, mund të përfitojnë nga skema mbështetëse sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria me akt nënligjor.

3. Mbështetja sipas Skemës Mbështetëse të krijuar me këtë ligj zbatohet për kapacitetin e plotë të një objekti për prodhim të energjisë ose për një pjesë të kapacitetit të tij.

4. Skema Mbështetëse për Prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme bazohet në Marrëveshje për Blerjen e Energjisë Elektrike, Kontratë për Premium ose Kontratë për Diferencë e nënshkruar në mes të Prodhuesit të Privilegjuar dhe Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe realizohet përmes:

4.1. Premiumeve nxitëse; ose

4.2. Tarifave nxitëse.

5. Përfituesit e Skemës Mbështetëse të përcaktuar me këtë ligj, përjashtimisht atyre të definuara me paragrafin 8 të këtij neni dhe nenin 40 të këtij ligji, përzgjidhen nëpërmjet një Procesi të Ofertimit Konkurrues në përputhje me nenet 16, 17, 18 dhe 19 të këtij ligji, dhe përcaktohen tutje me akte tjera nënligjore.

6. Ministria njofton operatorët e sistemit të rrjetit dhe komunat në lidhje me planet për zhvillimin e Proceseve Ofertuese Konkurruese në lokacione specifike. Pas pranimi të njoftimeve të tilla, operatorët e sistemeve dhe komunat ndërmarrin masat dhe veprimet e nevojshme, duke përfshirë përforcimet e rrjetit ose disponueshmërinë e kapacitetit të rrjetit, dhe/ose miratimin e planeve hapësinore dhe planet zhvillimore komunale dhe masat tjera relevante, për të akomoduar kërkesën e Ministrisë dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të Procesi të Ofertimit Konkurrues.

7. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e dhënies së një Kontrate të Mbështetjes për projekte nga Burime të Ripërtërishme të Energjisë të cilët kanë fituar statusin e investimit strategjik sipas legjislacionit në fuqi. Mbështetja duhet të jetë në përputhje me kontratën për mbështetje e cila nuk është më e lartë sesa çmimi më i ulët i pranuar në procesin e ofertimit konkurrues për teknologjinë e njejtë. Nëse nuk ka çmim të pranuar në procesin e ofertimit konkurrues, atëherë çmimi bazohet në metodologjinë për përcaktimin e premiumit maksimal fiks ose çmimit maksimal të fiksuar, të përcaktuar nga Rregullatori sipas nenit 11.5 të këtij ligji.

8. Çdo Skemë Mbështetëse e përcaktuar me këtë ligj dhe çdo mbështetje tjetër e përcaktuar me akt nënligjor miratohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndhmën Shtetërore.

9. Skema Mbështetëse nuk cenon asnjë obligim që rrjedh nga korniza ligjore në Kosovë në fuqi në datën e miratimit të këtij ligji, që zbatohet për cilindo prodhues të energjisë elektrike apo cilindo Prodhues të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

10. Teknologjitë e Energjisë së Ripërtërishme nga paragrafi 1 i këtij neni mbështeten me masa të tjera të përcaktuara nga Ministria ose institucione të tjera me pëlqimin e Ministrisë.

11. Ministria me akt nënligjor përcakton afatet dhe kushtet për dhënien e mbështetjes për prodhimin e energjisë termike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë ose bashkëprodhimin me efikasitet të lartë.

12. Mbështetja financiare për gjenerimin e energjisë termike ose bashkëprodhimin me efikasitet të lartë nga Burimet e Ripërtërishme, jepet përmes Procesit të Ofertimit Konkurrues ose përmes mbështetjes direkte, ku çmimi maksimal për vendosjen e tarifave për blerjen e energjisë termike nga furnizues termik publik bazohet në metodologjinë e miratuar nga Rregullatori.

Neni 11 Premiumi nxitës

1. Sipas sistemit të Premiumeve Nxitëse, mbështetja financiare u jepet Prodhuesve të Privilegjuar në formën e:

1.1. premiumit fiks, që është shumë fikse që i paguhet Prodhuesit të Privilegjuar mbi çmimin e tregut një ditë përpara, në bazë të Kontrates për Premium; ose

1.2. premiumit rrëshqitës simetrik, që është shumë ndërmjet Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent që i paguhet Prodhuesit të Privilegjuar ose nga Prodhuesi i Privilegjuar, në bazë të Kontrates për Diferencën.

2. Në rastin e premiumit të fiksuar do të ketë një Kontratë për Premium ku Prodhuesi i Privilegjuar e shet në tregun e organizuar një ditë përpara energjinë elektrike të prodhuar, ndërkohë që merr mbështetje financiare në formën e një premiumi fiks i cili barazohet me Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme ose autoritetin kompetent.

3. Në rast të premiumit rrëshqitës simetrik, do të ketë një Kontratë për Diferencë ku Prodhuesi i Privilegjuar e shet energjinë elektrike të prodhuar në tregun e organizuar një-ditë-para, duke bërë një barazim shtesë me Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme.

4. Dokumentacioni për procesin e ofertimit konkurrues përcakton kohëzgjatjen e Kontratës për Premiumin fiks dhe Kontratës për Diferencë, si dhe Premiumin rrëshqitës simetrik. Në çdo rast kur vendoset për kohëzgjatjen e Kontratës për Diferencë Ministria e shqyrtton teknologjinë, kushtet teknike të lokacionit specifik dhe rrethanat tjera relevante për përmblylljen e suksesshme të Procesit të Ofertimit Konkurrues.

5. Rregullatori harton dhe miraton Metodologjinë për përcaktimin e premiumit maksimal fiks ose të Çmimit maksimal të Fiksuar.

6. Rregullatori brenda një afati prej tridhjetë (30) ditëve nga kërkesa e Ministrisë cakton premiumin maksimal fiks ose Çmimin maksimal të Fiksuar për secilin Proces të Ofertimit Konkurrues.

Neni 12 Tarifa Nxitëse

1. Sipas sistemit për Tarifa Nxitëse, mbështetja jepet para se të plotësohen kushtet sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe derisa të zbatohet konvertimi në Kontratë për Diferencën në përputhje me paragrafet 4 dhe 5 të këtij neni.

2. Në kuadër të sistemit për Tarifa Nxitëse, mbështetja financiare u jepet Prodhuesve të Privilegjuar në formën e një çmimi të garantuar të blerjes për kWh për energjinë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme dhe të dorëzuar në rrjetin elektrik, në bazë të një Marrëveshjeje për Blerjen e Energjisë.

3. Marrëveshja për Blerjen e Energjisë në rastin e Tarifës Nxitëse do të ketë kohëzgjatjen e caktuar në dokumentacionin e Procesit të Ofertimit Konkurrues. Në secilin rast kur vendoset për kohëzgjatjen e Tarifës Nxitëse Ministria shqyrton teknologjinë, kushtet teknike të lokacionit specifik dhe rrethanat tjera relevante për përmbylljen e suksesshme të Procesit të Ofertimit Konkurrues.

4. Rregullatori harton dhe miraton metodologjinë për përcaktimin e tarifës nxitëse në formë të çmimit maksimal të garantuar të blerjes. Rregullatori vendos çmimin maksimal të garantuar të blerjes për secilin Proces të Ofertimit Konkurrues.

5. Rregullatori inicion konvertimin e Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë me sistemin e tarifave nxitëse në Kontrata për Diferencën, pasi të jenë plotësuar kushtet vijuese kumulative:

5.1. është themeluar dhe është funksional tregu një ditë përpara në Kosovë me të cilin operon Bursa Shqiptare e Energjisë; dhe

5.2. çmimi njësi në tregun një ditë përpara në Kosovë është barazuar për një periudhë të njëpasnjëshme prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

6. Rregullatori e publikon vlerësimin e vet për kushtet sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe konkluzionin e vet, me ç'rast Operatori i Energjisë së Ripërtërishme obligohet që Marrëveshjet efektive për Blerje të Energjisë t'i konvertojë në Kontrata për Diferencën.

7. Për cakun kombëtar dhe trajektoren, Ministria përcakton me akt nënligjor për çdo teknologji specifike kapacitetet totale që janë të pranueshme për të përfituar nga sistemi i Tarifave Nxitëse dhe/ose nga sistemi i Premiumit Nxitës.

Neni 13 **Ruajtja e Energjisë**

1. Prodhuesit e Privilegjuar që përdorin teknologjitë e ruajtjes të energjisë dhe që rrjedhimisht e ruajnë energjinë elektrike të prodhuar, mund të përfitojnë nga Skema Mbështetëse e krijuar me këtë ligj në momentin e plasimit të tij të planifikuar në rrjet.

2. Prodhuesi i Privilegjuar nuk përdor energjinë elektrike të tërhequr nga sistemi energjetik për mbushjen e sistemit të ruajtjes. Operatori i sistemit të transmetimit i siguron Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme informacionet përkatëse të nevojshme për të kompensuar pagesat e Skemës Mbështetëse në përputhje me këtë nen.

Neni 14

Përgjegjësia e Balancimit

1. Përveç Prodhuesve të Privilegjuar të përzgjedhur bazuar në Skemë Mbështetëse sipas këtij ligji, të gjithë Prodhuesit e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme mbajnë përgjegjësi të plotë balancuese në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike, rregullat e tregut dhe procedurat e tjera të miratuara nga Rregullatori. Secila palë përgjegjëse për balancim është përgjegjëse nga aspekti financiar për jobalancet e veta.

2. Për Prodhuesit e Privilegjuar, sipas vlerësimit të Rregullatorit, zbatohet margjina vijuese e gabimit të parashikimit deri në dymbëdhjetë (12) muaj, pasi që tregu i organizuar brenda ditës në Kosovë është funksional dhe likuid, me ç'rast përjashtohet pjesërisht nga obligimi që lidhet me përgjegjësinë balancuese dhe koston:

2.1. Në rast se vëllimi i jobalancit për periudhën e barazimit përfundimtar të jobalancit është maksimum dhjetë përqind (10%) për teknologjinë e erës dhe pesë përqind (5%) për teknologjinë solare e vlerës së planifikuar, për periudhën e barazimit të jobalancit, atëherë jo balancet nuk do t'i ngarkohen Prodhuesit të Privilegjuar;

2.2. Në rast se vëllimi i jobalancit është më i lartë se dhjetë përqind (10%) për teknologjinë e erës dhe pesë përqind (5%) për teknologjinë solare, vëllimi i jobalancit që bie mbi këtë prag ngarkohet ose barazohet me Prodhuesin e Privilegjuar në përputhje me Rregullat e Tregut dhe procedurat e tjera të miratuara nga Rregullatori;

2.3. Jobalancet sipas nën-paragrafit 2.1 dhe 2.2 të këtij neni të vlerës së përcaktuar për periudhën e barazimit të jobalancit kompensohen nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme prej Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme;

2.4. Pas miratimit të vendimit nga Rregullatori kur vlerësohet se tregu i organizuar në Kosovë është funksional dhe likuid, të gjithë Prodhuesit e Privilegjuar do të jenë plotësisht përgjegjës për balancimin në përputhje me Ligjin për energjinë elektrike, rregullat e tregut dhe procedurat e tjera të miratuara nga Rregullatori.

3. Projektet demonstruese për Teknologjitë Inovative të Ripërtërishme përjashtohen pjesërisht nga përgjegjësia e balancimit sipas nënparagrafit 2.1 dhe 2.2 të këtij neni për një kohëzgjatje të kufizuar dhe në atë masë të nevojshme për arritjen e qëllimeve demonstruese. Përjashtimi nga ky obligim përcaktohet me vendim të Ministrisë, në pajtim me mbështetjen e përkufizuar me nenin 10 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 15

Dispeçimi dhe Kufizimi

1. Energjia elektrike e prodhuar nga Prodhuesit e Privilegjuar i garantohet qasje transparente dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes bazuar në tarifatat e miratuara nga Rregullatori.

2. Prodhuesit e Privilegjuar kanë përparësi dispeçimi, duke iu nënshtruar çfarëdo kufizimi të përcaktuar vetëm për qëllime të sigurisë së sistemit siç përcaktohet nga kodet teknike.

3. Operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes kufizojnë energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar vetëm si veprim i mundësisë së fundit për të ruajtur sigurinë e funksionimit të sistemit të transmetimit dhe/ose sistemit të shpërndarjes.

4. Nëse operatori i sistemit të transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes, për shkak të sigurisë së funksionimit të sistemit të transmetimit dhe/ose sistemit të shpërndarjes, e kufizojnë plotësisht ose pjesërisht qasjen në sistem për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar, ata e njoftojnë Prodhuesin e Privilegjuar, Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme dhe Rregullatorin në lidhje me këtë, si dhe për masat korrigjuese të ndërmarra për të parandaluar kufizimet e mundshme të papërshtatshme.

5. Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Rregullatori harton metodologjinë për përcaktimin e vëllimit të kufizuar që i nënshtrohet kompensimit financiar përkatës për kufizimin në kuadër të Skemës Mbështetëse.

Neni 16

Dizajni dhe zbatimi i Procesit të Ofertimit Konkurrues

1. Ministria zhvillon dhe zbaton Procesin e Ofertimit Konkurrues sipas nenit 10 paragrafi 5 të këtij ligji, në bazë të kërkesave në pajtim me nenin 17 paragrafi 2 të këtij ligji.

2. Para çdo Procesi të Ofertimit Konkurrues dhe brenda kufijve të kapacitetit total për të cilën jepet mbështetja, Ministria lëshon një vendim për të filluar Procesin e Ofertimit Konkurrues dhe për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm.

3. Vendimi i Ministrisë për zhvillimin e Procesit të Ofertimit Konkurrues përmban minimalisht këto informacione:

3.1. Lloji ose llojet e teknologjive nga burimet e Ripërtërishme të Energjisë për të cilat parashihet të jepet mbështetja;

3.2. Kapaciteti total i instaluar për të cilin parashihet të jepet mbështetja;

3.3. Identifikimi i lokacionit në pronësi publike, duke përfshirë të dhënat për infrastrukturën ekzistuese, ose për lokacion jo-specifik;

3.4. Lloji i kontratës për mbështetjen e dhënë;

3.5. Kalendari për tërë Procesin e Ofertimit Konkurrues, si dhe realizimin e projektit për impiantin;

3.6. Kërkesa për të paraqitur pronarin përfundimtar përfitues;

3.7. Kërkesa që sigurojnë pjesëmarrje të ofertuesve me përvojë në ndërtim të impianteve me teknologji dhe kapacitet të instaluar ngjashëm apo të përafërt dhe posedojnë aftësi të realizimit të investimit në afatin e paraparë;

3.8. Kërkesa të parapara me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;

3.9. Afatet dhe kushtet tjera të zbatueshme për Procesin e Ofertimit Konkurrues.

4. Për çdo proces të Ofertimit Konkurrues Ministria krijon Komision Vlerësues, i cili përbëhet nga një përfaqësues i Rregullatorit, një përfaqësues i Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, një përfaqësues i Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe dy përfaqësues të Ministrisë njëri prej të cilit vepron si kryesues. Ministria ofron mbështetje administrative për Komisionin Vlerësues.

5. Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria miraton aktet nënligjore me të cilat përcaktohet Procesi i Ofertimit Konkurrues, dizajni dhe procedura e Procesit të Ofertimit Konkurrues, duke përfshirë edhe procesin e dorëzimit të ofertave elektronike dhe dokumentacionit përkatës, dhe kërkesat e detajuara për kualifikimin si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues.

Neni 17

Kërkesat minimale për kualifikimin

1. Të gjithë ofertuesit të cilët i plotësojnë kërkesat minimale për kualifikimin kanë mundësi të dorëzojnë oferta në një Proces të Ofertimit Konkurrues.

2. Kërkesat minimale për kualifikim dhe dokumentacioni tjetër ofertues bëhen publike me shpalljen e një Procesi të Ofertimit Konkurrues.

3. Komisioni i Vlerësimit i shqyrton të gjitha dokumentet e dorëzuara dhe vendos për përmbushjen e kërkesave minimale për kualifikim nga secili ofertues.

Neni 18

Procesi i Ofertimit Konkurrues

1. Ofertat renditen sipas çmimit të ofruar.

2. Përfshihen ofertat që tejkalojnë Premiumin maksimal Nxitës, Çmimin e Fiksuar ose Tarifën Nxitëse.

3. Njësia për zbatim të projekteve nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë është përgjegjëse për të përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar përmbyllje të suksesshme të Procesit të Ofertimit Konkurrues.

4. Ministria me akt nënligjor rregullon Procesin e Ofertimit Konkurrues.

Neni 19

Procesi i Përzgjedhjes dhe e Drejta e Ankesës

1. Pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, Komisioni Vlerësues përgatit listën e ofertuesve që i plotësojnë kërkesat për kualifikim, duke i renditur ata nga çmimi më i ulët deri te çmimi më i lartë i ofertuar.
2. Procesi i përzgjedhjes për vlerësimin e ofertës përcaktohet në akt nënligjor të miratuar nga Ministria, sipas nenit 16 paragrafi 5 të këtij ligji.
3. Kuotat për teknologji specifike plotësohen në varësi të renditjes prej Komisionit Vlerësues. Kur arrihet kapaciteti maksimal i përcaktuar me kuota, kuota konsiderohet e plotësuar ndërsa ofertuesit e mbetur dhe/ose kapaciteti i tepërt i ofertuesve të suksesshëm nuk përfitojnë nga Skema Mbështetëse.
4. Nëse dy ose më shumë ofertues ofertojnë me të njëjtin çmim, por kapacitetet e tyre të ofertuara e tejkalojnë kuotën e përcaktuar, kuota u shpërndahet këtyre ofertuesve në proporcion me kapacitetin e ofertuar të secilit impiant.
5. Komisioni Vlerësues e njofton Ministrinë për përfundimin e procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes, duke treguar ofertuesin ose ofertuesit fitues. Ministria njofton ofertuesin ose ofertuesit fitues për hapat dhe kërkesat e ardhshme në proces.
6. Pjesëmarrësi në Procesin e Ofertimit Konkurrues i cili konsideron se është dëmtuar në kundërshtim me nenet 17, 18 dhe 19 të këtij ligji dhe është i pa kënaqur me njoftimin e Ministrisë nga paragrafi 5 i këtij neni ka të drejtë të paraqesë ankesë në Ministri.
7. Vendimi i Ministrisë i nënshtrohet shqyrtimit nga gjykata kompetente me kërkesë të palëve në procedurë.

Neni 20

Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit

1. Pas marrjes së vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e ofertuesit të suksesshëm, ofertuesi i suksesshëm nënshkruan Marrëveshjen për Zhvillim të Projektit me Ministrin e Ministrisë brenda afatit të përcaktuar në dokumentacionin e Procesit të Ofertimit Konkurrues. Kushtet minimale të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit specifikohen nga Ministria në akt nënligjor.
2. Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit lejon bartjen e projektit tek një palë e tretë, me kusht që pala e tretë plotëson kushtet minimale të plotësuara nga ofertuesi fitues në një lloj të marrëveshjes direkte ose instrumente tjera në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare.
3. Nëse ofertuesi fitues nuk arrin ta nënshkruaj një Marrëveshje për Zhvillimin e Projektit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ofertuesit pasues në renditje ftohen të lidhin një Marrëveshje për Zhvillim të Projektit me çmimin e ofruar nga ofertuesi fitues.

4. Prodhuesit të Privilegjuar që lidh Marrëveshje për Zhvillim të Projektit sipas këtij neni, nuk i kërkohet të aplikojë për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja sipas kushteve të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. Prodhuesit të Privilegjuar që lidh Marrëveshje për Zhvillim të Projektit, i kërkohet të marrë të gjitha lejet e nevojshme për ndërtimin e impiantit siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.
6. Leja për prodhimin e energjisë i lëshohet Prodhuesit të Privilegjuar nga Rregullatori, nëse kërkohet sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
7. Nëse ofertuesi nuk i përmbush obligimet e parapara në paragrafin 5 të këtij neni, Ministria e ndërpret Marrëveshjen për Zhvillim të Projektit dhe inicion garancinë e performancës, siç parashihet me Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit.
8. Brenda shtatë (7) ditësh nga lëshimi i çertifikatës së shfrytëzimit për Prodhuesin e Privilegjuar për impiantin e përzgjedhur bazuar në Procesin e Ofertimit Konkurrues, Ministria lëshon çertifikatën e përfundimit që konfirmon fillimin e zbatimit të projektit.

Neni 21

Kontrata për Mbështetje

1. Ministria në konsultim me Rregullatorin dhe Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme harton Modelet e Kontratës për Mbështetje për secilin Proces të Ofertimit Konkurrues, dhe e publikon si pjesë e dokumentacionit për Procesin e Ofertimit Konkurrues.
2. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do t'i ruajë të gjitha shënimet e detajuara në lidhje me mbështetjen e dhënë në përputhje me këtë ligj gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës për Mbështetje, edhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vjetësh, duke përfshirë të gjitha informacionet relevante për të demonstruar se janë respektuar kushtet e Kontratës për Mbështetje. Rregullatori i publikon çdo vit detajet e llogaritjeve dhe pagesave sipas Kontratës për Mbështetje.
3. Ministria ka të drejtë të shkëpusë Kontratën për Mbështetje nëse Prodhuesi i Privilegjuar nuk i përmbush kriteret e vendosura me Kontratën për Mbështetje. Në këtë rast, Prodhuesi i Privilegjuar do ta humb statusin e Prodhuesit të Privilegjuar, pa të drejtën për ta rifituar statusin e tillë për impiantin e njëjtë.

Neni 22

Investimet Publike dhe Shfrytëzimi i tokës publike

1. Me vendim të Qeverisë dhe pas propozimit të Ministrisë, kapacitetet e reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë me investime publike apo bashkë investim publiko-privat, zhvillohen konform kërkesave nga paragrafi 3 i nenit 65 të këtij ligji.
2. Kriteret dhe kushtet për implementimin e procedurave për zhvillim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga paragrafi 1 i këtij neni dhe lloji i Kontratës për Mbështetje, përcaktohen me

vendim të Qeverisë kur autorizohet fillimi i procedurës së tenderimit sipas paragrafit 3 të nenit 65 të këtij ligji.

3. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në tokë publike, me përjashtim të drejtave të fituara në bazë të ligjit përkatës për Investime Strategjike apo zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese me investim publik të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, bazohet në Procesin e Ofertimit Konkurrues të zbatuar nga Ministria, ose bazuar në pëlqimin e Ministrisë nëse ndërtohet nga ndërmarrjet publike.

4. Ministria, sipas vendimit të Qeverisë, fiton të drejtat pronësore ose të drejtat për shfrytëzim të lokacioneve në pronësi publike që janë vlerësuar nga Ministria të kenë potencial për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë përmes Procesit të Ofertimit Konkurrues ose për ndërtim nga ndërmarrja publike sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Ministria ka të drejtë të jap me qira tokën publike për Prodhuesin e Privilegjuar për një periudhë të caktuar në dokumentacionin e Procesit të Ofertimit Konkurrues, por jo më shumë se katërdhjetë (40) vite.

6. Pas përfundimit të periudhës së Kontratës për Mbështetje, shuma e qirasë do të jetë në harmoni me kushtet e tregut.

7. Ministria ka të drejtë të kërkojë transferin e projektit ose të kërkojë dekomisionimin e impiantit pas përfundimit të periudhës së qirasë siç është përcaktuar në dokumentacionin e Procesit të Ofertimit Konkurrues.

Neni 23

Operatori i Energjisë së Ripërtërishme

1. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria, pas konsultimit me Rregullatorin, i propozon Qeverisë të caktojë ose themelojë subjektin që do të marrë kompetencat e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.

2. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme është marrësi fizik i energjisë elektrike të prodhuar nga Prodhuesit e Privilegjuar të cilëve u jepet mbështetje në bazë të një MBE-je.

3. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme trashëgon të gjitha MBE-të në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do ta shesë energjinë e blerë në bazë të MBE-ve që nuk kanë dispozitën për konvertim në Kontratë për Diferencë direkt në tregun e organizuar sapo ai të jetë funksional në përputhje me nenin 11 dhe 12 të këtij ligji.

4. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme është pala homologe kontraktuese e Prodhuesve të Privilegjuar për barazimin e pagesave sipas Kontratës për Mbështetje.

5. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme mban një regjistër publik në kohë reale të Prodhuesve të Privilegjuar, ku për secilin prej tyre paraqitet një dosje me këto informacione:

5.1. Emrin dhe vendndodhjen e Prodhuesit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;

- 5.2. Datën e lidhjes së Kontratës për Mbështetje, formën dhe nivelin e mbështetjes;
 - 5.3. Mbështetjen e ofruar që nga data e pranimit në Skemën Mbështetëse;
 - 5.4. Datën e përfundimit të periudhës së mbështetjes.
6. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme menaxhon Fondin Mbështetës të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme për të mbuluar kostot e Skemës Mbështetëse, në veçanti:
- 6.1. Diferencat e pagueshme ndërmjet Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent për Prodhuesit e Privilegjuar të cilëve u është dhënë mbështetje në bazë të një Kontrate për Diferencën dhe pagesave të premiumit për Prodhuesit e Privilegjuar të cilëve u është dhënë mbështetje në bazë të një Kontrate për Premium;
 - 6.2. Diferencat e pagueshme ndërmjet Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent për Prodhuesit e Privilegjuar të cilëve u është dhënë mbështetje në bazë të një Marrëveshje për Blerje të Energjisë bazuar në Tarifë Nxitëse;
 - 6.3. Kostot për mbulimin e jobalanceve për Prodhuesit e Privilegjuar që janë të përjashtuar pjesërisht nga përgjegjësia balancuese; dhe
 - 6.4. Kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to, koston e financimit, qasjen në treg, kapitalin punues dhe koston e ruajtjes së rezervave për të siguruar në vazhdimësi likuiditetin financiar dhe aftësinë paguese të Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme.
7. Rregullatori me vendim përcakton përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, duke përfshirë procesin e llogaritjes dhe përditësimit sistematik të Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme.

Neni 24

Fondi Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme

1. Kostot e Skemës Mbështetëse dhe të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme mbulohen nëpërmjet Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme që përbëhet nga fondet e arkëtuara në kuadër të Obligimeve të Energjisë të Ripërtërishme.
2. Fondet nga Obligimi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme llogariten sipas një metodologjie të zhvilluar dhe të miratuar nga Rregullatori.
3. Fondet nga Obligimi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme arkëtohen nga të gjithë furnizuesit që furnizojnë konsumatorët fundorë në baza mujore dhe llogariten për kWh të konsumuar.
4. Në interes të mbështetjes dhe garantimit të qëndrueshmërisë financiare të Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme u kërkon të gjithë furnizuesve të ofrojnë instrumentin e duhur të sigurimit të

pagesës që aktivizohet në rast se furnizuesi nuk i përmbush obligimet e veta të pagesës ndaj Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.

5. Konsumatori fundor përjashtohet nga pagesa e Obligimit për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme me kusht që:

5.1. Ka blerë Garancitë e Origjinës që mbulojnë të gjithë konsumin e vet; dhe

5.2. Konsumi i vet furnizohet nëpërmjet një kontrate të blerjes me një Prodhues të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme të cilit nuk i jepet mbështetje sipas këtij ligji.

6. Rregullatori miraton metodologjinë për të mundësuar instrumente të likuiditetit në mënyrë që të siguroj fondet e nevojshme për funksionimin normal financiar të Fondit Mbështetës për Energjinë nga Burimet e Ripërtërishme.

Neni 25

Skemat e Përbashkëta Mbështetëse

1. Qeveria, me propozim të Ministrisë, mund të vendosë ta bashkojë ose ta bashkërendojë pjesërisht Skemën Mbështetëse me skemën mbështetëse të një ose më shumë Palëve të Komunitetit të Energjisë.

2. Në raste të tilla, një sasi e caktuar e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme e prodhuar në territorin e Palës pjesëmarrëse të Komunitetit të Energjisë llogaritet në pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Republikën e Kosovës, ose anasjelltas, me kusht që:

2.1. bëhet transfer statistikor i sasive të caktuara të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme nga një vend në tjetrin, në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë për transferin statistikor të transpozuar në akt nënligjor; ose

2.2 vendoset një rregull për shpërndarjen e sasive të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme ndërmjet tyre, për të cilin është njoftuar Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, jo më vonë se tre (3) muaj pas përfundimit të vitit të parë në të cilin hyn në fuqi.

3. Brenda tre (3) muajve pas përfundimit të çdo viti në të cilin e ka bërë njoftimin sipas nënparagrafit 2.2 të këtij neni, Qeveria lëshon një letër njoftim që tregon sasinë totale të energjisë elektrike ose të energjisë për ngrohje ose ftohje të prodhuar gjatë vitit nga Burimet e Ripërtërishme dhe që i nënshtrohet rregullit të shpërndarjes.

4. Për llogaritjen e pjesëmarrjeve të Energjisë së Ripërtërishme sipas këtij ligji, sasia e energjisë elektrike ose e energjisë për ngrohje ose ftohje nga Burimet e Ripërtërishme e paraqitur sipas paragrafit 3 të këtij neni, rialokohet ndërmjet palëve të përfshira përmes rregullës për paraqitje të shpërndarjes.

Neni 26

Prodhuesit ekzistues të Energjisë së Ripërtërishme

1. Dispozitat e këtij ligji nuk ndikojnë negativisht në të drejtat e Prodhuesve të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, të cilëve u është dhënë mbështetje në kuadër të skemave mbështetëse të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Personi juridik ose fizik, i cili ka një Marrëveshje të vlefshme për Blerjen e Energjisë Elektrike të lidhur me Operatorin e Tregut të energjisë elektrike, sipas skemës së Tarifave Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë ose formë tjetër e mbështetjes, dhe që është në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk është i pranueshëm për mbështetje sipas dispozitave të këtij ligji për të njëjtin impiant për të cilin ekziston mbështetja.
3. Kontratat ekzistuese mbi bazën e të cilave jepet mbështetja sipas Skemave Mbështetëse të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e pajtuara, duke ruajtur kushtet ekonomike dhe teknike të kontratës ekzistuese. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme e shet energjinë elektrike nga këta Prodhues të Privilegjuar në tregun kombëtar një ditë përpara.
4. Kontratat ekzistuese mbi bazën e të cilave jepet mbështetja sipas Skemave Mbështetëse të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mundën në bazë të vullnetit të Prodhuesit të konvertohen në Kontratë për Diferencën me Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme, ku Prodhuesit e Privilegjuar shesin energjinë e tyre drejtpërdrejt në tregun kombëtar një ditë përpara dhe e barazojnë premiumin rrëshqitës me Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme. Nëse kontratat e tilla konvertohen në Kontrata për Diferencë, mbështetja e dhënë para hyrjes në fuqi të këtij ligji ndërpritet.

Neni 27

Publikimi dhe Transparenca

1. Ministria në planin e veprimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë të paraparë me paragrafin 2 të nenit 7 të këtij ligji paraqet shpërndarjen e mbështetjes që pritet deri në arritjen e cakut kombëtar.
2. Plani sipas paragrafit 1 të këtij neni rishikohet duke pasqyruar zhvillimet e fundit të tregut ose shpërndarjen e pritshme të mbështetjes.
3. Ministria në baza vjetore, publikon informacione për Proceset e mëparshme të Ofertimit Konkurrues, duke përfshirë shkallën e realizimit të projekteve.

KAPITULLI IV

VETË-KONSUMATORËT NGA ENERGJIA E RIPËRTËRISHME

Neni 28

Të drejtat dhe detyrimet e Vet-Konsumatorëve nga Energjia e Ripërtërishme

1. Çdo konsumator fundor ka të drejtë të ndërtojë stabiliment të Konsumit Vetanak nga burimet e Ripërtërishme dhe të bëhet Vetë-Konsumator me energji nga burimet e Ripërtërishme sipas këtyre kushteve:

1.1. Stabilimenti i Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme është i lidhur me instalimet e brendshme;

1.2. Kapaciteti total i instaluar i stabilimentit të Vetë-Konsumatorit me energji të Ripërtërishme është i barabartë ose më i vogël se kapaciteti i kyçjes i kontraktuar i konsumatorit, marrë parasysh që kapaciteti maksimal i lejuar i stabilimentit të Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme kufizohet nga operatori i sistemit të shpërndarjes ose ai i transmetimit për zona të caktuara dhe periudha kohore specifike, për shkak të kushteve teknike në rrjet në ato zona. Rregullatori i monitoron këto raste dhe aktivitetet e ndërlidhura të ndërmarra nga operatori i rrjetit për t'i adresuar këto kufizime, dhe është përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet operatorit të rrjetit dhe Vetë-Konsumatorit me Burime të Ripërtërishme;

1.3. Sasia vjetore e tepicës së energjisë elektrike të injektuar në rrjet nga Vetë-Konsumatori duhet të jetë më e vogël sesa sasia e energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti gjatë së njëjtës periudhë. Nëse energjia elektrike e injektuar në rrjet gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore është më e lartë sesa sasia e konsumuar gjatë së njëjtës periudhë, pjesa e tepicës së energjisë elektrike që tejkalon energjinë elektrike të konsumuar nuk kompensohet. Rregullatori e përcakton se nga cila datë fillon periudha dymbëdhjetë (12) mujore.

2. Çdo Vetë-Konsumator me burime të Ripërtërishme, qoftë pronar apo qiramarrës i pronës, ka të drejtën të:

2.1. prodhojë energji elektrike nga burime të Ripërtërishme për konsum vetanak, dhe tepicën e energjisë elektrike të vet-prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme ta ruajë dhe ta shesë, me kusht që, për një Vetë-Konsumator jo-familjar me burime të Ripërtërishme, këto aktivitete nuk përbëjnë veprimtarinë e vet kryesore tregtare ose profesionale. Kjo e drejtë realizohet pa iu nënshtruar:

2.1.1. procedurave dhe tarifave, taksave dhe ngarkesave diskriminuese dhe jo-proporcionale, si dhe tarifave të rrjetit që nuk reflektojnë kostot, në lidhje me energjinë elektrike që konsumon prej rrjetit ose injekton në rrjet;

2.1.2. procedurave diskriminuese ose jo-proporcionale, dhe çdo ngarkese ose tarifë në lidhje me energjinë elektrike të vet-prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme që mbetet brenda mjediseve të veta.

2.2. instalojë, të ketë në pronësi dhe të operojë sistemet për ruajtje të energjisë elektrike të kombinuara me instalimet që gjenerojnë energji elektrike nga Burime të Ripërtërishme për konsum vetanak, pa u detyruar të paguajë tarifë të dyfishtë, përfshirë tarifën e rrjetit për energjinë elektrike të ruajtur që mbetet brenda mjedisëve të veta. Sistemi për ruajtje të energjisë elektrike brenda instalimit të Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme do të:

2.2.1. mbushet me energji elektrike vetëm nga stabilimenti për vet-prodhim me burime të Ripërtërishme;

2.2.2. ketë të ndaluar të mbushet nga rrjeti, gjë që sipas legjislacionit përkatës konsiderohet si përdorim i paautorizuar i energjisë elektrike.

2.3. mbajë të drejtat dhe detyrimet e veta si konsumator fundor, duke përfshirë masat mbrojtëse dhe ndërrimin e furnizuesit.

2.4. pranojë kompensim, duke përfshirë edhe nëpërmjet Skemave Mbështetëse, aty ku është e zbatueshme për energjinë elektrike të Ripërtërishme të vet-prodhuar që e hedh në rrjet, e cila pasqyron vlerën e tregut të asaj energjie elektrike dhe që merr parasysh vlerën afatgjatë për rrjetin, mjedisin dhe shoqërinë.

2.5. lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet, sipas një skeme mbështetëse të miratuar nga Rregullatori, ose lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet sipas kushteve të dakorduara reciprokisht në lidhje me furnizimin dhe injektimin e energjisë elektrike.

2.6. angazhohet bashkërisht në aktivitetet sipas nën-paragrafëve 2.1., 2.2., 2.3., 2.4. dhe 2.5 të këtij neni në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet konsumatorëve fundorë nëse ata janë të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë ndërtesat shumë-banesore, dhe të organizojë ndarjen mes vete të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme që prodhohet në lokacionin e tyre ose në lokacionet e tyre; pa paragjykuar tarifën e rrjetit dhe çfarëdo ngarkese, tarife, pagese dhe takse përkatëse të zbatueshme për çdo Vetë-Konsumator me burime të Ripërtërishme.

3. Vetë-Konsumatori që përdor burime të Ripërtërishme është i detyruar të:

3.1. jetë i regjistruar si konsumator fundor, nëse në kohën e aplikimit nuk është konsumator fundor;

3.2. ketë marrë autorizimin nga Rregullatori për instalimin e stabilimentit të Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme, nëse autorizimi i tillë kërkohet me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

3.3. furnizojë energji elektrike nga e njëjta pikë matëse përmes së cilës e blen energjinë elektrike;

3.4. sigurojë që të gjitha instalimet e brendshme të stabilimentit të gjenerimit janë në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës dhe standardet teknike të aplikueshme;

3.5. informojë rregullisht për energjinë elektrike të prodhuar nga stabilimenti i Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme dhe energjinë elektrike të konsumuar. Rregullatori, përmes akteve nënligjore, përcakton subjektin përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, formatin, periudhat dhe afatet për raportim;

3.6. përmbushë të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara nga Rregullatori lidhur me pajisjet matëse shtesë në rastin e përcaktuar sipas këtij neni.

4. Rregullatori harton metodologji specifike për kthimin e kostove të operatorit të rrjetit të shkaktuara nga Vetë-Konsumatorët me burime të Ripërtërishme, duke përfshirë pagesat ose tarifatat specifike për Vetë-Konsumatorë me burime të Ripërtërishme, si një nënkategori e veçantë e përdoruesve të rrjetit, për të maksimizuar mbështetjen për rrjetin nga njëra anë, dhe për të zbutur rreziqet që lidhen me reflektimin dhe kthimin e kostove.

Neni 29

Instalimi i teknologjisë së energjisë së ripërtërishme në ndërtesa shumëbanesore

1. Vetë-Konsumatorët të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë ndërtesat shumëbanesore, kanë të drejtë të:

1.1. prodhojnë Energji të Ripërtërishme, duke përfshirë për konsumin e tyre vetanak, të ruajnë dhe shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme, duke përfshirë sasinë në kuadër të Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë së Ripërtërishme dhe përmes furnizuesve të energjisë elektrike dhe, pa iu nënshtruar:

1.1.1. procedurave dhe tarifave diskriminuese ose joproportionale, si dhe tarifave të rrjetit që nuk reflektojnë koston në lidhje me energjinë elektrike që ata konsumojnë ose injektojnë në rrjet;

1.1.2. procedurave diskriminuese ose joproportionale dhe çdo tarife ose ngarkese në lidhje me energjinë e tyre të prodhuar vet nga Burimet e energjisë së Ripërtërishme që mbetet brenda objekteve të tyre;

1.2. instalojnë dhe operojnë sistemet e ruajtjes së energjisë elektrike të kombinuara me instalimet që prodhojnë energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak duke mos u obliguar me ndonjë tarifë të dyfishtë, përfshirë tarifatat e rrjetit, për energjinë elektrike të ruajtur që mbetet brenda objekteve të tyre;

1.3. të ruajnë të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë fundorë;

1.4. për të pranuar kompensim, duke përfshirë edhe nëpërmjet Skemave Mbështetëse, aty ku është e zbatueshme, për energjinë elektrike të Ripërtërishme të prodhuar vet që ata injektojnë në rrjet, e cila pasqyron vlerën e tregut të asaj energjie elektrike dhe merr parasysh vlerën e saj afatgjatë për rrjetin, mjedisin dhe shoqërinë.

2. Vetë-Konsumatorët nga Burimet e Ripërtërishme të energjisë lejohen të organizojnë ndarjen mes vete të energjisë nga burimet e Ripërtërishme që prodhohet në lokacionin apo

lokacionet e tyre, pa paragjykuar tarifat e rrjetit dhe tarifat, taksat dhe ngarkesat tjera përkatëse të zbatueshme për secilin Vetë-Konsumator të burimeve të Ripërtërishme.

3. Vetë-Konsumatorët nga Burimet e Ripërtërishme në ndërtesat shumëbanesore organizohen në përputhje me kërkesat e ligjit për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.

4. Rregullatori përcakton kriteret e nevojshme për instalimin e stabilimenteve të Vetë-Konsumatorëve nga Burimet e Ripërtërishme të vendosura në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë ndërtesat shumëbanesore.

Neni 30

Skemat Mbështetëse për Vetë-Konsumatorë nga Burime të Ripërtërishme

1. Rregullatori, përmes akteve nënligjore, përcakton skemat për faturimin neto në dispozicion për Vetë-Konsumatorët nga Burimet e Ripërtërishme, duke përfshirë Prapun, të cilat bazohen në parimet e mëposhtme:

1.1. Furnizuesit të cilët furnizojnë Vetë-Konsumatorët nga burimet e Ripërtërishme janë të detyruar të lidhin kontratë furnizimi në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara me aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni, dhe ta marrin të gjithë tepricën e energjisë elektrike nga vetë-konsumatorët me burime të Ripërtërishme;

1.2. Vetë-Konsumatorët me burime të Ripërtërishme kanë të drejtën e kompensimit për tepricën e energjisë elektrike përmes një krediti monetar në euro të llogaritur në bazë të vlerës neto të energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti dhe vlerës së energjisë elektrike të injektuar në rrjet brenda një periudhe faturimi që merret parasysh gjatë përgatitjes së faturave të energjisë elektrike nga Furnizuesi;

1.3. Nëse krediti monetar i referuar në nën-paragrafin 1.2 të këtij neni është më i madh sesa vlera e komponentit të energjisë së tërhequr nga rrjeti për të njëjtën periudhë faturimi, shuma e kreditit në euro bartet në periudhën vijuese të faturimit. Krediti monetar duhet të përdoret nga Vetë-Konsumatori me burime të Ripërtërishme brenda një periudhe të caktuar prej jo më shumë se një viti, në të kundërtën është i pavlefshëm.

2. Rregullatori:

2.1. përcakton prapun;

2.2. përcakton çmimet dhe/ose metodologjinë për përcaktimin e vlerës monetare të tepricës së energjisë të injektuar në rrjet për çdo periudhë tarifore. Këto çmime dhe/ose metodologji rishikohen periodikisht, të paktën çdo dy (2) vjet;

2.3. përcakton kohëzgjatjen e periudhës në të cilën përdoret krediti monetar nga Vetë-Konsumatori me Burime të Ripërtërishme;

2.4. përcakton procedurat për aplikimin e skemës së faturimit neto;

2.5. përcakton periudhën gjatë së cilës Vetë-Konsumatori me Burime të Ripërtërishme ka të drejtën për të përfituar nga skema e faturimit neto.

3. Në pikën e kyçjes së një Vetë-Konsumatori me Burime të Ripërtërishme, operatori i rrjetit përkatës instalon një njehsor me dy drejtime që e regjistron veçmas energjinë elektrike të injektuar në rrjet dhe energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti. Në rastin e Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme që veprojnë bashkërisht, numri dhe lloji i pajisjeve të matjes përcaktohen me aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Vetë-Konsumatori me burime të Ripërtërishme merr pjesë në grupin balancues të furnizuesit të tyre.

5. Rregullatori miraton rregullat specifike të raportimit për Vetë-Konsumatorët me Burime të Ripërtërishme, që përmban të paktën këto kërkesa dhe parime:

5.1. Vetë-Konsumatori me Burime të Ripërtërishme, vet ose përmes operatorit të rrjetit, dorëzon të dhënat për energjinë elektrike të prodhuar dhe të konsumuar:

5.2. Sasia e energjisë elektrike të prodhuar dhe të konsumuar nga Vetë-Konsumatori me burime të Ripërtërishme nga kategoria e amvisërive dhe vetë-konsumatorëve me burime të Ripërtërishme që veprojnë bashkërisht, vlerësohet në bazë të Metodologjisë së përcaktuar nga Rregullatori;

5.3. Të dhënat sipas nën-paragrafeve 5.1 dhe 5.2 të këtij neni përfshihen gjatë llogaritjes së pjesës së energjisë së Ripërtërishme në Konsumin Bruto Përfundimtar të energjisë.

6. Komunitat janë të detyruara të harmonizojnë rregulloret ekzistuese dhe/ose të reja lidhur me thjeshtëzimin e procedurave për marrjen e lejes së nevojshme për instalimin e pajisjeve të Vetë-konsumatorit me Burime të Ripërtërishme.

7. Rregullatori, harton dhe miraton akt nënligjor për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për instalimin e pajisjeve të Vetë-konsumatorëve me burime të Ripërtërishme mbi Pragan.

Neni 31 **Vetë-Konsumatorët**

1. Rregullatori miraton rregullat për autorizimin e Vet-Konsumatorëve që përdorin Burime të Ripërtërishme dhe kyqen në rrjet, bazuar në kriteret e mëposhtme:

1.1. Procedurat e autorizimit duhet të jenë të qarta, të thjeshta, gjithëpërfshirëse, transparente, proporcionale dhe të efektshme në nivele të ndryshme administrative dhe autoritete kompetente, përfshirë komunikimet përmes pikës së vetme të kontaktit;

1.2. Procedurat për amvisëritë thjeshtohen për të mundësuar përfundimin brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit tek Rregullatori.

2. Rregullatori krijon një regjistër të Vet-Konsumatorëve me burime të Ripërtërishme, i cili përfshinë, ndër të tjera, informatat e mëposhtme:

- 2.1. emrin dhe adresën e vetë-konsumatorit;
 - 2.2. kategorinë e konsumatorit;
 - 2.3. llojin e teknologjisë së përdorur në stabilimentin e Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme;
 - 2.4. lokacionin e stabilimentit të Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme;
 - 2.5. kapacitetin e instaluar të Vetë-Konsumatorit me burime të Ripërtërishme;
 - 2.6. kapacitetin e kontraktuar të kyçjes së konsumatorit.
3. Operatori i rrjetit miraton procedura të thjeshtuara në lidhje me para kushtet teknike për kyçje në rrjet.
 4. Pëlqimi apo leja përkatëse për instalim lëshohet nga Komuna sipas legjislacionit në fuqi.
 5. Brenda nëntë (9) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, operatori i sistemit identifikon konsumatorët me Instalime vet-prodhuese pas njehsorit që janë funksional por që nuk janë të regjistruar në bazën e të dhënave të Rregullatorit. Lista e konsumatorëve të tillë të identifikuar dorëzohet tek Rregullatori.
 6. Të gjithë konsumatorët që kanë instaluar teknologji bazuar në Energji të Ripërtërishme për vet-prodhim pas njehsorit që janë aktiv në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të regjistrohen tek Rregullatori, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar nga Rregullatori.
 7. Konsumatorët që instalojnë instalime të vet-prodhimit pas njehsorit të një kapaciteti deri në një (1) MW njoftojnë Rregullatorin brenda afatit të caktuar nga Rregullatori.
 8. Konsumatorët që instalojnë instalime të vet-prodhimit pas njehsorit me një kapacitet të instaluar mbi një (1) MW aplikojnë tek Rregullatori për tu pajisur me autorizim për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese.
 9. Konsumatorët të cilët instalojnë Instalime për vet-prodhim pas njehsorit dhe nuk njoftojnë Rregullatorin sipas paragrafit 7 dhe 8 të këtij neni, denohen me gjobë nga Rregullatori si vijon:
 - 9.1. prej treqind (300) euro deri në nënqind (900) euro, personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik; dhe
 - 9.2. prej njëmijë (1.000) euro deri në tre mijë (3.000) euro, personi fizik që ushtron biznes individual dhe personi juridik.

KAPITULLI V

BASHKËSITË PËR ENERGJI NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME

Neni 32

Anëtarët ose aksionarët e Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme

1. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme përbëhet nga anëtarë ose aksionarë, të organizuar në formë organizate me zotësi juridike në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe statutin e tyre të themelimit.
2. Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme qëllim themelor kanë plotësimin e nevojave të konsumit vetanak të anëtarëve ose aksionarëve të saj, si dhe kontributin në përmirësim mjedisor dhe në dobi sociale të anëtarëve ose aksionarëve të saj.
3. Anëtarët ose aksionarët e një Bashkësie për Energji nga burimet e Ripërtërishme mund të jenë persona fizikë, NMVM, komunat dhe konsumatorët, duke përfshirë familjet me të hyra të ulëta ose të cenueshme.
4. Pjesëmarrja në çdo Bashkësi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme është vullnetare dhe e hapur. Çdo person apo subjekt i listuar në paragrafin 3 të këtij neni ka të drejtë t'i bashkohet Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme ose të largohet prej saj, në përputhje me kushtet përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ndaj tyre nuk mund tu aplikohen procedura diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në një Bashkësi për Energji të Ripërtërishme ose tërheqjen prej saj.
5. NMVM-të mund të marrin pjesë në Bashkësinë e Energjisë së Ripërtërishme, me kusht që pjesëmarrja e tyre nuk është aktiviteti i tyre primar komercial ose profesional dhe se pjesëmarrja e tyre nuk kalon dhjetë përqind (10%) të pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve dhe aksionarëve të asaj Bashkësie për Energji të Ripërtërishme.
6. Anëtarët e një Bashkësie për Energji nga Burimet e Ripërtërishme mbajnë të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë fundorë, duke përfshirë ndërrimin e lirshëm të furnizuesve.
7. Për aq sa teknikisht është e mundshme dhe bazuar në njohje të ndërsjellë Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme mundëson pjesëmarrjen ndërkufitare të anëtarëve ose aksionarëve të Bashkësisë.

Neni 33

Qeverisja e Bashkësive me Energji nga Burimet e Ripërtërishme

1. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme zhvillon, investon dhe zbaton projekte për burime të Ripërtërishme të energjisë dhe efikasitet të energjisë.
2. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme përbën një subjekt juridik autonom, i cili vepron në emër të vet dhe të ushtrorë të drejta dhe të jetë subjekt i detyrimeve, i pavarur nga anëtarët dhe aksionarët e vet. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme kontrollon në mënyrë efektive nga aksionarët ose anëtarët e vendosur në afërsi të projekteve

të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme që janë pronë e atij subjekti juridik dhe zhvillohen prej tij.

3. Kontrolli efektiv, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, ushtrohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Rregullatori nxjerr akt nënligjor që përcakton rregullat për autorizim, kushtet e operimit, procedurat për regjistrim, dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme. Bashkësitë për energji nga burime të ripërtërishme përfitojnë të drejta të dhëna siç përcaktohet në Kapitullin V të këtij ligji.

Neni 34

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme

1. Bashkësitë për Energji nga burimet e Ripërtërishme kanë të drejtë:

1.1. të prodhojnë, konsumojnë, ruajnë, dhe shesin energjinë nga burimet e Ripërtërishme, përfshirë përmes Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë së Ripërtërishme;

1.2. ta ndajnë mes anëtarëve dhe aksionarëve të Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme energjinë që prodhohet nga njësitë e prodhimit në pronësi të asaj Bashkësie për Energji të Ripërtërishme, bazuar në një marrëveshje për ndarjen mes anëtarëve ose aksionarëve të Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme;

1.3. të kenë qasje në të gjitha tregjet relevante të energjisë, drejtpërdrejt ose përmes grumbullimit në mënyrë jodiskriminuese në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike.

1.4. Në rastet kur prodhojnë energji elektrike, trajtohen ngjashëm me kategorinë e Vetë-konsumatorëve, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore.

2. Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme mund të përfitojnë nga Skemat Mbështetëse në përputhje me rregullat dhe standardet teknike të sigurisë së sistemit. Mënyra e përfitimit nga skema mbështetëse përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Rregullatori.

3. Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme u nënshtrohen dispozitave të zbatueshme për aktivitetet që kryejnë, duke përfshirë autorizimin dhe licencimin në përputhje me kushtet e parapara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

4. Bashkësitë për Energji të Ripërtërishme u nënshtrohen tarifave të rrjetit që reflektojnë kostot të përcaktuara nga Rregullatori, si dhe tarifave, ngarkesave dhe taksave përkatëse.

5. Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme trajtohen në mënyrë jo-diskriminuese në lidhje me aktivitetet, të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë fundorë, prodhues, ose furnizues.

6. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme ka një anëtarësi prej së paku dhjetë (10) anëtarë ose aksionarë, afërsia e të cilëve nga stabilimenti rregullohet me akt nënligjor. Jo

më shumë se dhjetë (10%) të anëtarëve apo aksionarëve mund të jenë në pronësi të NMVM-ve.

7. Rregullatori miraton akt nënligjor që specifikon të drejtat dhe detyrimet e operatorit të sistemit të shpërndarjes, furnizuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut në lidhje me kyçjen, ndarjen e energjisë, matjen, përgjegjësinë e balancës, faturimin, kompensimin dhe çështjet tjera relevante për funksionimin e Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme.

Neni 35

Heqja e barrierave dhe politikat mundësuese të Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme

1. Rregullatori vlerëson barrierat ekzistuese dhe potencialin për zhvillim të Bashkësive për Energji të Ripërtërishme në Republikën e Kosovës. Vlerësimi është pjesë e raporteve të progresit në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

2. Vlerësimi sipas paragrafit 1 të këtij neni përfshinë një vlerësim të:

2.1. gjendjes ekzistuese, potencialit dhe zhvillimit të Bashkësive për Energji të Ripërtërishme;

2.2. ekzistencës së barrierave dhe kufizimeve të pajustificuara për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkësive për Energji nga Burimet e Ripërtërishme;

2.3. propozimeve për amendamente.

3. Rregullatori u ofron autoriteteve publike mbështetje rregullative për ngritjen e kapaciteteve për të mundësuar themelimin e Bashkësive për Energji të Ripërtërishme.

KAPITULLI VI

KYÇJA NË RRJET DHE DETYRIMET E OPERATORËVE TË RRJETIT

Neni 36

Kyçja në rrjet

1. Operatorët e rrjetit kanë detyrimin sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij ligji të zhvillojnë infrastrukturën e rrjetit dhe rrjetet inteligjente për të lejuar funksionimin e sigurt të sistemit energjetik, veçanërisht në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për energjinë elektrike.

2. Operatorët e rrjetit obligohen të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të lejuar qasje dhe ofrojnë kushtet për të kyçur në rrjet Prodhuesit nga Energjia e Ripërtërishme, Bashkësitë për Energji të Ripërtërishme dhe vetë-konsumatorët me burime të Ripërtërishme duke u bazuar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, dhe Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe Metodologjinë e Taksave të Sistemit

të Shpërndarjes, që miratohen nga Rregullatori sipas këtij Ligji, Ligjit për Energji dhe Ligjit për Energjinë Elektrike.

3. Procesi i kyçjes bazohet në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese, dhe pa barrë shtesë administrative, duke pasur gjithmonë parasysh funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes.

4. Me rastin e përcaktimit të kushteve për qasje në rrjet, dhe pasi të jenë marrë parasysh planet e Ministrisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë bazuar në Procesin e Ofertimit Konkurrues dhe planet për investime publike apo bashkë investim publiko-privat, Operatorët e Rrjetit vëjnë në dispozicion kapacitetin maksimal të sistemeve, me kusht që të respektohen standardet e sigurisë në fuqi dhe nevojës për funksionim të sigurt të sistemit.

5. Operatori i Rrjetit i ofron Prodhuesit të ri me Energji të Ripërtërishme të Energjisë, Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme ose Vetë-konsumatorit me energji nga burime të Ripërtërishme që dëshiron të kyçet në sistem, këto të dhëna:

5.1. informatën teknike për kyçjen në rrjet, një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të detajuar të kostove të lidhura me kyçjen, duke përfshirë pikën e kyçjes e cila i ka kushtet më të favorshme nga pikëpamja e koston dhe distancës deri në rrjet, duke marrë parasysh kufizimet e mundshme të rrjetit;

5.2. afat kohor për marrjen dhe përpunimin e kërkesës për kyçje në rrjet sipas niveleve të tensionit duke përfshirë vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të detajuar të kostove të lidhura me kyçjen dhe vlefshmërinë e ofertës në pajtim me Metodologjitë e kyçjes të përgatitura nga Operatorët e Rrjetit;

5.3. një plan kohor indikativ për çdo kyçje të propozuar në rrjet, dhe për të cilën Operatori i Rrjetit vendosë një tarifë që pasqyron kostot e tij të arsyeshme në pajtim me Metodologjinë përkatëse të miratuar nga Rregullatori.

Neni 37

Procedura e thjeshtë e njoftimit

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes propozon dhe Rregullatori aprovon një procedurë të thjeshtë për kyçjet në rrjet të Vetë-Konsumatorëve me burime të Ripërtërishme dhe projektet demonstruese, me kapacitet elektrik deri në pesëdhjetë (50) kW ose më pak, me kusht që të ruhet stabiliteti, besueshmëria dhe siguria e rrjetit.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes, brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh pas aplikimit, aprovon ose refuzon kyçjen e kërkuar në rrjet, ose propozon një pikë alternative të kyçjes në rrjet bazuar në shqetësime të justifikuara të sigurisë ose papajtueshmërinë teknike të komponenteve të sistemit.

Neni 38

Kostoja për kyçje në sistemin e rrjetit dhe zgjerimin e kapacitetit

1. Prodhuesi me Energji nga Burimet e Ripërtërishme, Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme ose Vetë-Konsumatori që përdor Burime të Ripërtërishme, mbulon koston e pikës së kyçjes duke përfshirë ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve të nevojshme të matjes për të regjistruar energjinë elektrike të furnizuar dhe pranuar, kostot potenciale të përfundimit të rrjetit, si dhe është përgjegjës për çdo ndryshim në këto çështje.
2. Nëse pas aprovimit të kyçjes Operatori i Rrjetit bën ndryshime në pikën e kyçjes ose në pajisjet e matjes, atëherë operatori i mbulon edhe kostot përkatëse. Operatori i Rrjetit mbulon kostot e optimizimit, forcimit dhe zgjerimit të sistemit të shpërndarjes në pajtim me metodologjinë përkatëse të taksave për kyçje të aprovuar nga Rregullatori.

KAPITULLI VII

PROMOVIMI I PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIME TË RIPËRTËRISHME PËR NGROHJE DHE FTOHJE

Neni 39

Kritja e pjesës së energjisë së Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes

1. Pjesëmarrja e Energjisë së Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes llogaritet në përputhje me trajektoren indikative të miratuar nga Ministria.
2. Ministria vlerëson potencialin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme dhe Humbjet nga Ngrohja dhe Ftohja. Ky vlerësim, kur është e përshtatshme, përfshin analizën hapësinore të zonave të përshtatshme për instalim me rrezik të ulët ekologjik dhe potencialin për projekte të vogla shtëpiake, si dhe përfshihet në vlerësimin gjithëpërfshirës sipas Ligjit për Eficiencën e Energjisë dhe siç kërkohet në përditësimet e mëvonshme të vlerësimeve gjithëpërfshirëse.

Neni 40

Masat për rritjen e pjesëmarjes së Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes

1. Ministria, me akt nënligjor, brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, vendos masat për nxitjen e zhvillimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes, duke u siguruar njëkohësisht që sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes Qendrore të kontribuojnë në trajektoren indikative sipas paragrafit 1 të nenit 39 të këtij ligji.
2. Masat e parapara në këtë nen synojnë prioritizimin e teknologjive më të mira të disponueshme, të qasshme për të gjithë konsumatorët, veçanërisht ata në amvisëri me të hyra të ulëta dhe kategori të cenueshme.
3. Masat e përcaktuara sipas këtij neni vendosen në bazë të kritereve objektive dhe jodiskriminuese dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndihmën Shtetërore.

4. Ministria vendos masa nxitëse për instalimin e sistemeve efikente të ngrohjes dhe ftohjes me burime të Ripërtërishme dhe për zëvendësimin e instalimeve të ngrohjes të bazuara në lëndë fosile në ndërtesa. Për të zëvendësuar instalimet e ngrohjes të bazuara në lëndë fosile, Ministria mban një inventar të instalimeve të tilla.

5. Ministria vendos masa stimuluese për përdorimin e Energjisë së Ripërtërishme ose të Nxehtësisë nga Mbetjet në proceset industriale të ngrohjes dhe ftohjes.

6. Ministria përcakton autoritetin përkatës për trajnimin dhe çertifikimin e instaluesve të teknologjive të Ripërtërishme, si kaldaja dhe stufa të vogla me biomasë, sisteme solare fotovoltaike dhe solare termike, sisteme të cekëta Gjeo-termale dhe pompa të nxehtësisë.

7. Prodhuesi i energjisë ngrohëse ose ftohëse nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë mund të fitojë të drejtën e përdorimit të subvencioneve për blerjen e pajisjeve që përdoren për prodhimin e energjisë ngrohëse ose ftohëse nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, në pajtim me këtë ligj dhe aktet nën ligjore.

Neni 41 Ngrohja ose Ftohja Qendrore

1. Operatori i Sistemit Termik lidhë furnizuesit e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme dhe nga Mbetjet e Energjisë Termike dhe blen ngrohjen ose ftohjen nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe Humbjet e Ngrohjes dhe Ftohjes nga furnizuesit si palë të treta.

2. Operatori i Sistemit Termik mund të refuzojë kyçjen dhe blerjen e ngrohjes ose ftohjes nga pala e tretë furnizuese nëse:

2.1. sistemit i mungon kapaciteti i nevojshëm për shkak të furnizimeve të tjera nga Mbetjet e nxehtësisë ose të ftohjes nga burime të Ripërtërishme të energjisë ose ngrohjes dhe të ftohjes të prodhuar nga bashkëprodhimi me efikasitet të lartë;

2.2. ngrohja ose ftohja nga palët e treta furnizuese nuk i plotëson parametrat teknik të nevojshëm për kyçje dhe siguroar funksionimin e besueshëm dhe të sigurt të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes qendrore;

2.3. Operatori i Sistemit Termik mund të demonstrojë se ofrimi i qasjes do të çonte në rritje të tepruar të kostos së ngrohjes ose të ftohjes për konsumatorët fundor në krahasim me koston e përdorimit të furnizimit kryesor lokal të ngrohjes ose të ftohjes me të cilin do të konkurronte burimi i ripërtëritshëm ose Humbja e Ngrohjes dhe Ftohjes.

3. Kur Operatori i Sistemit Termik refuzon kyçjen e një furnizuesi të ngrohjes ose ftohjes sipas paragrafit 2 të këtij neni, ai i jep furnizuesit si palë e tretë dhe Rregullatorit, informatat përkatëse mbi arsyet e refuzimit, si dhe kushtet që duhet të plotësohen dhe masat që duhen marrë në sistem për të mundësuar kyçjen.

4. Operatori i Sistemit Termik përshkruan dhe publikon në ueb faqen e vet kushtet dhe procedurat për kyçje dhe blerjen e ngrohjes ose të ftohjes sipas këtij neni, siç miratohen nga Rregullatori.

Neni 42
Të drejtat e Konsumatorëve të Ngrohjes dhe Ftohjes Qendrore

1. Furnizuesit e Ngrohjes dhe Ftohjes Qendrore, në ueb faqen e tyre, në faturën vjetore, ose me kërkesë të konsumatorëve fundor, në një mënyrë tjetër lehtësisht të qasshme, vëjnë në dispozicion të konsumatorëve fundorë informacionin mbi performancën energjetike dhe pjesën e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.
2. Rregullatori i përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për ushtrimin e të drejtës së shkyçjes.
3. Çdo ndërtesë e re lidhet me sistem eficient të ngrohjes ose ftohjes qendrore, përveç nëse një investitor demonstroi se zgjidhja e planifikuar alternative e furnizimit për ngrohje ose ftohje rezultoi në performancë dukshëm më të mirë energjetike.

KAPITULLI VIII
PROMOVIMI I PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET E
RIPËRTËRISHME NË TRANSPORT

Neni 43
Rritja e pjesës së energjisë nga burimet e Ripërtërishme në sektorin e transportit

1. Ministria përgjegjëse për sektorin e derivateve në koordinim me Ministrinë shqyrtojnë dhe analizojnë potencialin e Kosovës për të aprovuar pjesëmarrjen e energjisë së Ripërtërishme në sektorin e transportit çdo dy (2) vjet. Ky shqyrtim merr parasysh pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në konsumin përfundimtar të energjisë në sektorin e transportit për të arritur deri në vitin 2030.
2. Pjesëmarrja e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e transportit llogaritet në përputhje me metodologjinë e llogaritjes të miratuar nga Ministria.
3. Në shqyrtimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria, bazuar në propozimin e ministrisë përgjegjëse për sektorin e derivateve dhe Ministrisë përcakton pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme për t'u arritur në konsumin përfundimtar në sektorin e transportit.

Neni 44
Masat për rritjen e pjesëmarrjes së energjisë së Ripërtërishme në sektorin e transportit

Me qëllim të nxitjes së përdorimit të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e transportit për qëllime të nenit 43 të këtij ligji, Qeveria, në afat brenda nëntë (9) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, bazuar në propozimin e ministrisë përgjegjëse për sektorin e derivateve dhe Ministrisë miraton masat e nevojshme për implementim të këtij kapitulli.

KAPITULLI IX

KRITERET PËR QËNDRUESHMËRINË DHE KURSIMET E EMETIMEVE TË GAZRAVE SERË PËR BIO-KARBURANTET, BIO-LËNGJET DHE DERIVATET PREJ BIOMASE

Neni 45

Kriteret për qëndrueshmërinë

1. Energjia nga Bio-karburantet, Bio-lëngjet dhe derivatet prej Biomase, të prodhuara nga Biomasa Bujqësore dhe Biomasa Pyjore, si dhe nga mbeturinat dhe Mbetjet që rrjedhin nga toka bujqësore, pavarësisht nëse Bio-karburantet, Bio-lëngjet dhe Biomasa janë kultivuar apo kanë derivuar prej brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, konsiderohet për nën-paragrafet 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni vetëm nëse përmbushen kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë të përcaktuar në akt nënligjor të miratuar sipas paragrafit 2 të këtij neni:

1.1. kontribuon në cakun e Komunitetit të Energjisë për vitin 2030 dhe cakun për pjesëmarrjen e energjisë së Ripërtërishme në konsumin përfundimtar të energjisë në Republikën e Kosovës, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji;

1.2. përcaktimi i pajtueshmërisë me kërkesat e lidhura për uljen e gazrave serë, llojin dhe shfrytëzimin e tokës, ndikimin në biodiversitetet dhe zonat e mbrojtura, ndikimin në mbulesën e tokës dhe pyjeve, si dhe ndikimin e politikave bujqësore, siç specifikohet në ligjet dhe rregulloret përkatëse të Republikës së Kosovës;

1.3. përcaktimi i pajtueshmërisë me obligimin e lidhur me Energjinë e Ripërtërishme, duke përfshirë obligimin e paraparë në nenin 43 dhe 44 të këtij ligji;

1.4. pranueshmëria për të marrë mbështetje financiare për konsumin e Bio-karburateve, Bio-lëngjeve dhe derivateve prej Biomases.

2. Kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministria përgjegjëse për mjedisin, sipas legjislacionit përkatës në fuqi si dhe në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

3. Instalimet që përdorin derivate prej Biomase për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjen dhe ftohjen, e kanë obligim të jenë në pajtueshmëri me kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë të përcaktuara në akt nënligjor nga paragrafi 2 i nenit 44 të këtij ligji, vetëm nëse inputi termik total i vlerësuar i tyre është i barabartë me ose më shumë se njëzet (20) MW në rastin e derivateve të ngurta prej Biomases, dhe me input termik total të vlerësuar të barabartë ose më të madh se dz (2) MW në rastin e derivateve të gazta prej Biomases.

4. Energjia elektrike nga derivatet prej Biomases konsiderohen për qëllimet e përcaktuara në nënparagrafet 1.1, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni vetëm nëse plotëson një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme:

4.1. prodhohet në instalime me input termik total të vlerësuar nën pesëdhjetë (50) MW;

4.2. për instalimet me input termik total të vlerësuar nga pesëdhjetë (50) deri në njëqind (100) MW, prodhohet duke aplikuar teknologji të Kogjenerimit me efikasitet të lartë, ose, për instalimet vetëm me energji elektrike, përmbush një nivel të efikasitetit të energjisë që lidhet me teknikat më të mira të disponueshme;

4.3. për instalimet me input termik total të vlerësuar mbi njëqind (100) MW, prodhimi bëhet duke aplikuar teknologji të kogjenerimit me efikasitet të lartë, ose, për instalimet vetëm me energji elektrike, duke arritur efikasitet neto elektrike prej të paktën tridhjetë e gjashtë përqind (36%);

4.4. prodhohet duke aplikuar kapjen dhe ruajtjen e CO₂ prej Biomassës.

5. Për nën-paragrafet 4.1. 4.2 dhe 4.3 të këtij neni, instalimet vetëm me energji elektrike konsiderohen vetëm nëse nuk përdorin derivate fosile si derivate kryesore dhe vetëm nëse nuk ka potencial me kosto efektive për aplikimin e teknologjisë së kogjenerimit me efikasitet të lartë sipas vlerësimit nga legjislativi përkatës në fuqi si dhe në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

6. Nën-paragrafet 4.1. 4.2 dhe 4.3 të këtij neni vlejnë vetëm për instalimet që fillojnë funksionimin ose konvertohen për përdorim të derivateve prej Biomase pas datës 25 dhjetor 2024.

7. Nën-paragrafi 4.4. i këtij neni, nuk paragjykon mbështetjen e dhënë sipas Skemave Mbështetëse sipas kërkesave të këtij ligji, legjislativi përkatës në fuqi si dhe në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 46

Verifikimi i pajtueshmërisë së Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe derivateve prej Biomassës me kriteret për qëndrueshmërinë

1. Nëse Bio-karburantet, Bio-lëngjet dhe derivatet prej Biomassës duhet të merren parasysh për qëllimet e parapara me paragrafin 1 të nenit 45 të këtij ligji, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë.

2. Për paragrafin 1 të këtij neni, operatorët ekonomikë përdorin sistemin e balancës së masës që:

2.1. mundëson përzierjen e dërgesave të lëndëve të para ose bio-karburanteve me karakteristika të ndryshme të qëndrueshmërisë dhe të kursimeve të emetimeve të gazrave serë;

2.2. mundëson përzierjen e dërgesave të lëndëve të para me përmbajtje të ndryshme energjetike për përpunim të mëtejshëm;

2.3. kërkon që një përzierje të shoqërohet me informacion për karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe përmasat e dërgesave të përmendura në nën-paragrafin 2.1 të këtij paragrafi;

2.4. siguron që shuma e të gjitha dërgesave të marra nga një përzierje të përshkruhet në të njëjtën sasi dhe me të njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë si shuma e dërgesës së shtuar në përzierje, si dhe kërkon që balanca të arrihet gjatë një periudhe të përshtatshme;

2.5. siguron që çdo dërgesë të llogaritet vetëm një herë në konsumin përfundimtar bruto të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme; Konsumin Bruto Përfundimtar të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes; ose konsumin përfundimtar të energjisë nga burimet e Ripërtërishme në sektorin e transportit;

2.6. siguron informacion nëse është ofruar mbështetje për prodhimin e atyre dërgesave.

3. Operatorët ekonomik paraqesin informacion të saktë në lidhje me pajtueshmërinë me kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë, si dhe i vënë në dispozicion të dhënat relevante që janë përdorur për përgatitjen e këtij informacioni. Operatorët ekonomik aranzhojnë auditim të pavarur të informacionit të dorëzuar si dhe ofrojnë dëshmi se auditimi është kryer. Auditimi i pavarur konfirmon që sistemet e përdorura janë të sakta, të besueshme dhe të mbrojtura nga falsifikimi. Gjatë kryerjes së një auditimi të pavarur, vlerësohen shpeshësia dhe metodologjia e mostrimit dhe besueshmëria e të dhënave.

4. Informacioni sipas paragrafit 3 të këtij neni përfshinë informacion të duhur dhe të përshtatshëm për Bio-lëngje dhe Biomase për masat e marra për mbrojtjen e tokës, ujit dhe ajrit, sanimin e tokës së degraduar, si dhe shmangien e konsumit të tepërt të ujit në territoret me mungesë uji.

5. Obligimet e parapara nga ky nen përmbushen pavarësisht nga origjina gjeografike e Biomases së Bio-lëngjeve.

6. Qeveria, së bashku me Ministrinë, sigurojnë që informacioni nga paragrafi 3 i këtij neni i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në formë të standardizuar.

7. Operatorët ekonomik verifikojnë që lëndët e para dhe/ose Bio-karburantet, Bio-lëngjet dhe derivatet prej Biomase, janë në pajtueshmëri me kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë, duke marrë certifikata nga skemat vullnetare kombëtare ose ndërkombëtare të aprovuara ose të njohura nga autoritetet kompetente.

8. Qeveria, me propozimin e Ministrisë dhe ministria përgjegjëse për sektorin e derivateve dhe ministria përgjegjëse për mjedisin, krijojnë një skemë kombëtare certifikimi që përcakton standardet për prodhimin e Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe Derivateve prej Biomases, dhe të certifikojë përmbushjen nga operatorët ekonomik të atyre standardeve dhe kriterëve për qëndrueshmërinë dhe kriterëve për kursimet e emetimeve të gazrave serë.

9. Në rastin e vendosjes së një skeme kombëtare çertifikimi, organet e çertifikimit mbikëqyren nga autoritetet kompetente. Organet e çertifikimit dorëzojnë, me kërkesë të autoriteteve kompetente, të gjithë informacionin relevant të nevojshëm për ta mbikëqyrur operimin, duke përfshirë datën, kohën dhe lokacionin e saktë të auditimeve.

10. Skemat kombëtare dhe ndërkombëtare vullnetare, që vendosin standarde për produktet prej Biomases, janë në pajtueshmëri me standardet e besueshmërisë dhe transparencës, si dhe standardet e duhura për kryerjen e një auditimi të pavarur. Nëse këto skema masin kursimet neto të emetimeve të gazrave serë, ato i plotësojnë edhe kërkesat e metodologjive të përcaktuara nga rregullat që vlerësojnë ndikimin e gazrave serë të Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe derivateve prej Biomase dhe krahasuesve të tyre prej derivateve fosile, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi.

11. Ministria, ministria përgjegjëse për sektorin e derivateve dhe ministria përgjegjëse për mjedisin, bashkëpunojnë në përgatitjen e aktit nënligjor për zbatimin e sistemit të balancës së masës, përcaktimin dhe ekzekutimin e procesit të verifikimit të pajtueshmërisë së Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe derivateve prej Biomases me kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emetimeve të gazrave serë, secila për fushën e vet përkatëse të përgjegjësisë, dhe nxirret akt nënligjor për zbatimin e këtij nenit të miratuar nga Qeveria.

Neni 47

Llogaritja e ndikimit të gazrave serë prej Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe Derivateve prej Biomases

Qeveria, bazuar në propozimin e Ministrisë miraton aktet nënligjore për llogaritjen e ndikimit të gazrave serrë të Bio-karburanteve, Bio-lëngjeve dhe derivateve prej Biomase dhe krahasuesve të tyre prej derivateve fosile.

KAPITULLI X TEKNOLOGJITË INOVATIVE

Neni 48

Përdorimi i Teknologjive Inovative të Ripërtërishme

1. Për të rritur përdorimin e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, si dhe për të mbështetur integrimin e sistemit energjetik, inkurajohet zhvillimi i Teknologjive Inovative të Ripërtërishme.

2. Rregullatori lëshon autorizim të përkohshëm për aplikantët e interesuar, për të zhvilluar dhe testuar Teknologji Inovative të Ripërtërishme.

Neni 49 Mbështetja

Qeveria, me propozim të Ministrisë, vendos masa për mbështetjen e zhvillimit dhe përdorimit të Teknologjive Inovative të Ripërtërishme, në veçanti për hidrogjen të ripërtërishëm të nxjerrë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për Ndhimën Shtetërore.

KAPITULLI XI PROCEDURAT DHE KËRKESAT ADMINISTRATIVE

Neni 50

Parimet e procedurave administrative për projektet e energjisë së Ripërtërishme

1. Rregullatori siguron që rregullat në lidhje me procedurat e autorizimit, çertifikimit dhe licencimit që zbatohen për impiantet dhe rrjetet përcjellëse të transmetimit dhe shpërndarjes për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjen ose ftohjen nga Burimet e Ripërtërishme, deri në procesin e transformimit të Biomassës në Bio-karburante, Bio-lëngje, derivate të Biomassës ose produkte të tjera energjetike, si dhe për derivatet e Ripërtërishme të lëngshme dhe të gazta për transport me origjinë jobiologjike, janë proporcionale dhe të nevojshme dhe kontribuojnë në zbatimin e projekteve të Energjisë së Ripërtërishme.
2. Institucionet qendrore dhe lokale, Rregullatori dhe operatorët e rrjetit, të autorizuar nga ky ligj për të lëshuar pëlqime, leje, ose çfarëdo dokumenti tjetër për ndërtimin e projekteve të Energjisë së Ripërtërishme, marrin masat e nevojshme për të përmirësuar dhe përsheptuar procedurat e lëshimit në nivelin e duhur administrativ të dokumenteve të tilla, duke përcaktuar afatin sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.
3. Institucionet qendrore dhe lokale, Rregullatori dhe operatorët e rrjetit shqyrtojnë aplikimet për projektet e energjisë së Ripërtërishme në mënyrë jodiskriminuese, objektive, transparente dhe proporcionale, si dhe merren plotësisht parasysh veçoritë e secilës teknologji për Energji së Ripërtërishme.
4. Ngarkesat administrative të paguara nga konsumatorët janë transparente dhe të ndërlidhura me kostot.

Neni 51

Procesi i dhënies së lejes

1. Institucionet qendrore dhe lokale, Rregullatori dhe operatorët e rrjetit, sipas këtij ligji me autoritetin për të lëshuar pëlqime, leje, autorizime dhe licenca ose çfarëdo dokumenti tjetër për projekte të energjisë së Ripërtërishme, caktojnë një pikë të vetme kontakti. Këto pika kontakti, me kërkesë të aplikuesit, udhëheqin dhe lehtësojnë të gjithë aplikimin administrativ për leje dhe procesin e dhënies së tyre në kuadër të entitetit përgjegjës.

2. Pika e kontaktit në kuadër të institucionit qendror dhe lokal, Rregullatorit dhe operatorit të rrjetit, e drejton aplikantin gjatë procesit të aplikimit për leje administrative në mënyrë transparente deri në dorëzimin e një ose disa vendimeve nga autoritetet përgjegjëse në fund të procesit, i siguron aplikantit të gjithë informacionin e nevojshëm, si dhe i përfshin, sipas rastit, autoritetet e tjera administrative. Aplikantëve u lejohet t'i dorëzojnë dokumentet relevante edhe në formë digjitale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

3. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria e vë në dispozicion manualin e procedurave për zhvilluesit e projekteve me Energji të Ripërtërishme. Informacioni është i qasshëm edhe në kohë reale ku në mënyrë të veçantë adresohen projektet e vogla dhe projektet për Konsum Vetanak nga Burimet e Ripërtërishme. Informacioni në kohë reale tregon edhe pikën përkatëse të kontaktit për aplikim.

Neni 52 **One Stop Shop**

1. One Stop Shop funksionon si pikë e vetme e kontaktit në kuadër të Ministrisë, shërben për të lehtësuar dhe koordinuar aktivitetet e institucioneve të ndryshme gjatë shqyrtimit të aplikimeve për projektet e energjisë së Ripërtërishme.

2. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria miraton akt nënligjor për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive specifike për funksionimin e One Stop Shop, sipas këtij ligji.

KAPITULLI XII **GARANCIA E ORIGJINËS**

Neni 53 **Autoriteti kompetent**

1. Rregullatori është autoriteti kompetent për lëshimin e Garancisë së Origjinës dhe mbanë regjistrin, si dhe është përgjegjës për korrektësinë, besueshmërinë dhe mbrojtjen nga mashtrimi.

2. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes ia dorëzojnë Rregullatorit të dhënat për energjinë e prodhuar për të cilën është lëshuar Garancia e Origjinës.

3. Brenda nëntë (9) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Rregullatori miraton akt nënligjor që e rregullon mënyrën për sigurimin e të dhënave për energjinë e prodhuar, të matur në vendin e bartjes në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe për monitorimin.

4. Rregullatori rimburohet për lëshimin dhe bartjen e Garancisë së Origjinës. Kjo tarifë rimbursimi arkëtohet përmes një tarife për pjesëmarrje në Sistemin e Garancive të Origjinës, bazuar në kostot e arsyetuara që lidhen me mbajtjen e regjistrit të Garancive të Origjinës.

5. Prodhuesi i Privilegjuar nuk ka të drejtë për Garancinë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar për të cilën jepet mbështetja.

Neni 54

Lëshimi, bartja dhe anulimi i Garancive të Origjinës

1. Rregullatori lëshon Garancinë e Origjinës me kërkesë të prodhuesit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.
2. Garancia e Origjinës ka një madhësi standarde prej një (1) MWh. Nuk lëshohet më shumë se një Garanci e Origjinës për çdo njësi të energjisë së prodhuar.
3. Garancia e Origjinës është e vlefshme për dymbëdhjetë (12) muaj duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën lëshohet dhe anulohet më së largu gjashtë (6) muaj pas përfundimit të vlefshmërisë së tyre.
4. Garancia e Origjinës transferohet në mënyrë të pavarur nga shitja e energjisë së prodhuar me të cilën lidhen.
5. Garancia e origjinës mund të shitet, ndërsa energjia nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në lidhje me të cilën është shitur ndarazi Garancia shoqëruese e origjinës nga prodhuesi nuk i shpaloset ose shitet konsumatorit fundor si energji nga burimet e Ripërtërishme.

Neni 55

Përmbajtja e Garancive të Origjinës

1. Garancia e Origjinës specifikon të paktën:
 - 1.1. burimin e energjisë nga i cili është prodhuar energjia dhe kohën e fillimit dhe mbarimit, si dhe datat e prodhimit;
 - 1.2. nëse lidhet me:
 - 1.2.1. energji elektrike;
 - 1.2.2. gaz, duke përfshirë hidrogjenin;
 - 1.2.3. ngrohje ose ftohje;
 - 1.3. identitetin, lokacionin, llojin dhe kapacitetin e instalimit ku është prodhuar energjia;
 - 1.4. nëse instalimi ka përfituar nga Skema Mbështetëse dhe llojin e mbështetjes;
 - 1.5. datën në të cilën instalimi bëhet funksional;
 - 1.6. data dhe vendi i lëshimit dhe një numër identifikues unik.

Neni 56

Regjistri për Garancitë e Origjinës

1. Rregullatori krijon dhe mirëmban një regjistër elektronik me qëllim të lëshimit, bartjes dhe anulimit të Garancisë së Origjinës së energjisë elektrike.
2. Regjistri duhet të jetë në harmoni me Standardin Evropian CEN 16325 dhe Parimet dhe Rregullat e Veprimit të Sistemit Evropian për Çertifikim të Energjisë (EECS).
3. Regjistri do të jetë në gjendje të kyçet në sistemin rajonal për Garancitë e Origjinës të krijuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
4. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Rregullatori miraton rregullat për lëshimin e Garancive të Origjinës, duke përfshirë përdorimin e regjistrit të Garancive të Origjinës dhe tarifatat për pjesëmarrje në sistemin e Garancive të Origjinës.

Neni 57

Garancitë e Origjinës për prodhuesit në kuadër të Skemës Mbështetëse

1. Nëse një Prodhues i Privilegjuar merr mbështetje financiare sipas një Skeme Mbështetëse, Rregullatori siguron që vlera e tregut e Garancisë së Origjinës për të njëjtin prodhim të merret parasysh në përputhje me rrethanat në Skemën Mbështetëse relevante. Vlera e tregut e Garancisë së Origjinës duhet të merret parasysh në përputhje me rrethanat sa herë që jepet mbështetje financiare në Proces të Ofertimit Konkurrues.
2. Në rast se një Prodhuesi të Privilegjuar i jepet mbështetje në formën e një Tarife Nxitëse të vendosur në mënyrë administrative, Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme i lëshohet një Garanci e Origjinës. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme ose do t'ua shesë Garancitë e Origjinës direkt furnizuesve ose konsumatorëve ose këtë do ta bëjë përmes një aranzhmani konkurrues, dhe të ardhurat do t'i transferoj në Fondin Mbështetës të Burimeve të Ripërtërishme.
3. Furnizuesi i energjisë elektrike që i kërkohet të dëshmojë pjesëmarrjen ose sasinë e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në miksin e saj energjetik me qëllim të ofrimit të informacionit për origjinën e energjisë elektrike për konsumatorët e saj në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike do ta bëjnë këtë duke shfrytëzuar Garancitë e Origjinës, përveç sa i përket pjesës së miksit të saj energjetik që korrespondon me ofertat komerciale të pagjurmura, në rast se ka, për të cilat furnizuesi mund të shfrytëzojë miksin rezidual. Një detyrim i tillë vendoset në mënyrë transparente dhe të barabartë ndërmjet furnizuesve të ndryshëm.

Neni 58

Njohja e Garancive të Origjinës

1. Garancia e Origjinës e lëshuar në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian ose në Palën tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, njihet në Republikën e Kosovës, me kusht që

Garancia e Origjinës përmban elementet e referuara në nën-paragrafët 1.1., 1.2., 1.3., 1.4., 1.5 dhe 1.6., të nenit 55 të këtij ligji.

2. Garancia e Origjinës për aq sa ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë dhe vërtetësinë e saj refuzohet nga Rregullatori, duke përfshirë edhe mosnjohjen reciproke të Garancive të Origjinës të lëshuara në përputhje me Ligjin nga një shtet tjetër anëtar ose Palë Kontraktuese dhe njoftohet Ministria.

Neni 59

Llogaritja e pjesës së të gjitha llojeve të burimeve të energjisë në energjinë elektrike të shitur

1. Rregullatori llogarit dhe i publikon në ueb faqen e vet pjesët e të gjitha llojeve të burimeve të energjisë në energjinë elektrike të shitur tek konsumatorët fundorë në Republikën e Kosovës.

2. Në kuadër të llogaritjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, Rregullatori merr në konsideratë në veçanti Garancitë e Origjinës të përdorura dhe të skaduara.

3. Furnizuesi llogarit dhe ia tregon konsumatorit fundor të dhënat për pjesën e secilit burim të energjisë në totalin e energjisë elektrike të shitur në bazë të të dhënave të publikuara nga Rregullatori, sipas paragrafit 1 të këtij neni, dhe Garancive të përdorura të Origjinës.

4. Në afat prej nëntë (9) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria përcakton me akt nënligjor mënyrën e llogaritjes dhe paraqitjes së pjesës së të gjitha llojeve të burimeve të energjisë në energjinë e shitur elektrike dhe mënyrën e kontrollit për llogaritjet.

KAPITULLI XIII MONITORIMI DHE INSPEKTIMET

Neni 60 Monitorimi

1. Ministria dhe Rregullatori vazhdimisht monitorojnë arritjen e objektivave të këtij ligji, si dhe i identifikojnë zhvillimet që pengojnë arritjen e objektivave të tilla.

2. Rregullatori dorëzon një raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës, siç kërkohet me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, si dhe sipas dispozitave të këtij neni, i cili përmban të paktën:

2.1. detaje rreth zhvillimit dhe progresit aktual të zgjerimit të burimeve të Ripërtërishme, sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga energjia e Ripërtërishme dhe e injektuar në rrjet si total si dhe e zbërthyer sipas teknologjisë;

2.2. një përmbledhje të aplikimeve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese me teknologji të Ripërtërishme, duke përfshirë Komunitetet e Energjisë së Ripërtërishme;

2.3. detaje mbi mbështetjen e ofruar nëpërmjet Skemës Mbështetëse, duke përfshirë numrin e autorizimeve të lëshuara për konsum Vetanak nga Energjia e burimeve të Ripërtërishme;

2.4. informata mbi promovimin e përdorimit të Energjisë së Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes dhe përdorimin e Energjisë së Ripërtërishme në sektorin e transportit.

3. Ministria monitoron rregullisht pjesëmarrjen e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Bruto Konsumin Përfundimtar të energjisë, si dhe i koordinon aktivitetet me ministritë e tjera dhe Qeverinë për monitorimin e arritjes së objektivave sipas këtij ligji, si dhe i identifikon zhvillimet që pengojnë arritjen e objektivave të tilla.

Neni 61 Mbikëqyrja

1. Subjektet, të cilëve u janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet sipas këtij ligji, janë të detyruara që me kërkesë të Ministrisë t'i dorëzojnë të gjitha të dhënat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji.

2. Rregullatori, në pajtim me kërkesat e këtij ligji dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, e mbikëqyr kryerjen e aktiviteteve energjetike nga subjektet e autorizuara të pajisura me leje.

Neni 62 Inspektimet

1. Ministria, përmes Njesisë Inspektuese monitoron zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

2. Njësia e inspektimit është kompetente në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera përkatëse të energjisë bën inspektime në objektet energjetike dhe përgatit raporte inspektimi.

3. Inspektorët e njësisë së inspektimit e mbajnë konfidencial çdo informacion zyrtar ose komercial që mund t'u bëhet i njohur gjatë ose në lidhje me kryerjen e inspektimeve të tyre.

4. Inspektorët e njësisë së inspektimit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre të vetëm ose, nëse kërkohet, të shoqëruar nga organe të specializuara të kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 63

Statistikat

Të gjitha subjektet që prodhojnë Energji nga Burimet e Ripërtërishme obligohen t'i dorëzojnë Rregullatorit të dhënat e tyre vjetore të prodhimit të energjisë, jo më vonë se deri më 31 Mars të secilit vit, pagesat e detyrimeve financiare, si dhe të dhënat e tjera të përcaktuara me aktet nënligjore të nxjerra nga Rregullatori. Të dhënat paraqiten sipas gjinisë dhe moshës kur është e përshtatshme.

KAPITULLI XIV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 64

Prodhuesit ekzistues nga Burimet e Ripërtërishme

1. Të gjitha kontratat, lejet dhe autorizimet e lëshuara për Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten të pandryshuara deri në përfundimin e tyre. Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme kanë të drejtë të largohen nga një skemë mbështetëse ekzistuese, siç parashihet me këtë ligj dhe me akt nënligjor.
2. Çdo aplikim i iniciuar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji shqyrtohet bazuar në ligjin në fuqi në kohën e Aplikimit, përveç nëse Aplikuesi formalisht kërkon që Aplikacioni të trajtohet sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 65

Investimet strategjike dhe Partneriteti Publiko-Privat

1. Për të mbështetur investimet strategjike në Energjinë e Ripërtërishme në Republikën e Kosovës, autoritetet kompetente identifikojnë projektet strategjike, të përcaktuara në legjislacionin relevant.
2. Çdo investim strategjik në Energjinë e Ripërtërishme në Republikën e Kosovës sa i përket mbështetjes financiare bazohet në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj.
3. Në përputhje me kërkesat e ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Qeveria mund të autorizojë fillimin e procedurës së tenderimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për tu zhvilluar sipas dispozitave të aplikueshme të ligjit për Partneritet Publiko-Privat, duke paraparë formën e mbështetjes sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 66

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ministria, Rregullatori apo cildo subjekt tjetër varësisht nga rasti, janë të detyruar t'i miratojnë dhe harmonizojnë aktet nënligjore për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, brenda

nëntë (9) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ky ligj kërkon miratim të mëhershëm.

2. Neni 65, paragrafi 2 i këtij ligji vlen edhe për investitorët të cilëve u është dhënë statusi i investimit strategjik para miratimit të këtij ligji, duke iu nënshtruar të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje ligjërishit detyruese midis investitorit dhe Qeverisë.

Neni 67 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen nenet 12, 13, 14, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë.

Neni 68 Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-258
04 prill 2024**

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës